



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

R A P O R T I
I PUNËS SË GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
PËR VITIN 2021

Shkup, 2022

HYRJE

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me Rendin kushtetues dhe ndarjen e pushtetit në ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor është gjykatë më e lartë në Republikë që siguron zbatimin unik të ligjeve dhe është bartëse e pushtetit gjyqësor.

Në vitin raportues 2021 Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut kompetencat e veta kushtetuese dhe ligjore i realizoi në kushte të jashtëzakonshme si rezultat i pandemisë të shkaktuar nga Kovid – 19, por edhe me numër të zvogëluar të gjyqtarëve dhe të nëpunësve gjyqësorë.

Edhe krahas kushteve të tilla të vështira në përputhje me Ligjin për gjykatat në kuadër të **kompetencës reale** të saj, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut si gjykatë më e lartë vendos në shkallën e tretë dhe të fundit për ankesat kundër vendimeve të gjykatave të apelit, për mjete të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të plotfuqishme dhe vendimeve të këshillave të saj kur ajo është e përcaktuar me ligj, për konflikt të interesave dhe përcaktimin e kompetencës vendore, vendos për kërkesa për shkeljen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, në shkallë të parë dhe të dytë, në procedurë të përcaktuar me ligj para gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në përputhje me rregullat dhe principet e përcaktuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore dhe duke u nisur nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe çështje tjera të përcaktuara me ligj.

Kompetencën e saj Gjykata e realizon përmes **Sektorit të veprave penale, Sektorit të veprave civile, Sektorit për gjykim në afat të arsyeshëm dhe këshillave të specializuara për veprim** për kërkesat për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutën dhe për ankesat nga kandidatët të cilët nuk janë zgjedhur për gjyqtarë, respektivisht Kryetar të gjykatës.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, **kompetencën e saj kushtetuese për sigurimin e zbatimit unik të ligjeve nga ana e gjykatave** në Republikën e Maqedonisë së Veriut, fillimisht e realizon përmes punës së **Seancës së përgjithshme**, kompetenca e të cilës është definuar sipas Ligjit për gjykatat ku është paraparë se miraton qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore për çështje me kuptim për sigurimin e barazisë në zbatimin unik të ligjeve nga ana e gjykatave, për iniciativa nga avokatë, jep mendime për propozime të ligjeve dhe rregullave tjera kur me ato rregullohen çështje me kuptim të punës së gjykatave, shqyrton çështje lidhur me punën e gjykatave, zbatimin e ligjeve dhe praktikën gjyqësore, emëron përbërjen e këshillit për vendimmarrjen e ankesave kundër aktvendimeve të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për shkarkimin e gjyqtarit ose për masën e shqiptuar disiplinore ku marrin pjesë nga tre gjyqtarë nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut të zgjedhur me anë të shortit dhe punë të tjera të parapara me ligj.

Kompetenca për unifikimin e praktikës gjyqësore realizohet edhe përmes punës së **Sektorit të praktikës gjyqësore** dhe të **seancave të sektorëve gjyqësorë** ku miratohen mendimet juridike, nxirren konkluzione dhe miratohen sentenca.

Sipas **parimit të transparencës**, qëndrimet e miratuara parimore dhe mendimet juridike parimore, mendimet juridike, konkluzionet, sentencat dhe njoftimet nga kompetenca e Seancës së përgjithshme dhe seancave të sektorëve rregullisht publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës.

Me vendim të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, funksionin e gjyqtarit e ushtrojnë 28 (njëzet e tetë) gjyqtarë, në mënyrë që gjyqtarit që është zgjedhur si anëtar i Këshillit gjyqësor, funksioni i gjyqtarit i pezullohet. Gjatë vitit një gjyqtari i është shqiptuar masë e largimit nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, ndërsa në fund të vitit me Vendim të Këshillit gjyqësor funksioni i 1 (një) gjyqtari është vënë në mënyrë të pezulluar. Me vendet e zbrazura të gjyqtarëve me bazë të ndryshme nga vitet e kaluara të cilat nuk janë plotësuar, funksionin e gjyqtarit gjatë vitit 2021 e ushtronin 18 (tetëmbëdhjetë) gjyqtarë.

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut i ka plotësuar kompetencat e saj si anëtare sipas funksionit në Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Këshillit të Buxhetit Gjyqësor, ndërsa sipas Ligjit dhe Rregullores gjyqësore i realizoi të gjitha kompetencat e **Administratës gjyqësore**, dhe po ashtu i realizoi të gjitha komunikimet e rregullta dhe bashkëpunimin me gjykatat, me institucionet vendore, me organizatat joqeveritare dhe me përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare.

Në realizimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore, Kryetari dhe të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut morën pjesë në punën e Seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, seancës së gjyqtarëve, seancës së sektorëve, punën në këshillat, si dhe në aktivitete tjera në përputhje me ligjin, të orientuara në zbatimin më efikas të Kushtetutës, ligjeve, marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare dhe praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me vendim të Kryetarit të gjykatës është formuar Trupi punues për standardizimin e përdorimit dhe përparimit të programit AKMIS në gjykatat, që udhëhiqet nga një gjyqtar i Gjykatës Supreme në mbledhjet e të cilave është vendosur për kërkesa konkrete nga gjykatat lidhur me zbatimin e programit AKMIS.

Në vitin aktual rregullisht është vepruar edhe për kërkesat e palëve sipas Ligjit për qasje të lirë të informatave me karakter publik.

Kuadri administrativ profesional ekzistues krahas angazhimit në punën e këshillave gjykues, sipas Orarit të punës së gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore për vitin 2021, ka treguar aktivitet të rëndësishëm edhe me pjesëmarrjen në edukime të organizuara nga Akademia e gjyqtarëve dhe prokurorëve publik si dëgjues, por edhe si edukatorë në tema nga Programi për trajnim të Akademisë.

Sipas Ligjit për gjykatat në Gjykatën Supreme është formuar dhe funksionon qendra e informatikës me bazën e të dhënave për teknologjinë informatike, kompetente për udhëheqjen me sistemin e automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore dhe bazat e të dhënave që rezultojnë nga puna e gjykatave.

Vëllimi dhe intensiteti i punës është shprehur përmes të dhënave për veprim të Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në kuadër të kompetencës së saj dhe përmes të dhënave të punës së sektorëve dhe këshillave të specializuara për lëndë konkrete gjatë tërë vitit dhe masa e aktivitete tjera që janë ndërmarrë nga Gjykata, si gjykatë më e lartë në Republikën.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Të dhënat e Administratës gjyqësore nga fushëveprimi i punës së Kryetarit të gjykatës janë shfaqur në Tabelën në vijim:

Sfera	Administrata gjyqësore						
Lloji i lëndës	Evidencat e administratës gjyqësore						
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Lëndë të administratës gjyqësore	0	2428	0	0	2428	2428	0
Gjithsej – lloji i lëndës	0	2428	0	0	2428	2428	0
Lloji i lëndës	Parashtrësia dhe ankesa						
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Qasje të lirë në informacione	0	29	0	0	29	29	0
Evidenca e parashtrësive dhe ankesave	0	204	0	0	204	204	0
Gjithsej – lloji i lëndës	0	233	0	0	233	233	0
Gjithsej - sfera	0	2661	0	0	2661	2661	0

Parashtrësia, propozime dhe kërkesa tjera nga administrata gjyqësore

Gjatë vitit 2021, në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, janë pranuar gjithsej 204 parashtrësia të evidentuara në Regjistrin UPP.

Prej gjithsej parashtrësive të parashtruara, të evidentuara në Regjistrin UPP, 118 janë kërkesa për kryerjen më të shpejtë të lëndëve, ndërsa 86 janë parashtrësia nga persona tjerë fizik dhe juridik, institucione dhe organe tjera shtetërore.

Sipas Rregullores së punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari prej gjithsej 118 kërkesave të reja të pranuar për kryerjen me prioritet të lëndëve, ka miratuar 48, ka refuzuar 18, ndërsa për lëndët tjera janë marrë informacione se lëndët janë marrë në punë, respektivisht se procedura e lëndës konkrete ka përfunduar, kurse lënda është dërguar në gjykatën më të ulët kompetente ose palës në procedurë.

Prej gjithsej 204 parashtrësive të dorëzuara, të evidentuara në Regjistrin UPP, janë evidentuar 17 parashtrësia të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 5 parashtrësia të Avokatit të Popullit, përkatësisht 4 të Ministrisë së Drejtësisë, me kërkesë për informacion lidhur me revizion të parashtruar, kohëzgjatja e procedurës dhe të tjera.

Për kërkesat e parashtruara sipas bazave të ndryshme të evidentuara në Regjistrin UPP, Gjykata Supreme ka vepruar sipas Ligjit për gjykatat, Ligjit për veprim ndaj parashtrësive dhe propozimeve, sipas Rregullores së punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Rregullores gjyqësore dhe sipas Ligjit për udhëheqje me qarkullimin e lëndëve në gjykata.

Kërkesa për përjashtim – SU – IZZ / 2021

Numri total i kërkesave të parashtruara për përjashtim: 145

-numri i kërkesave të parashtruara nga palët për përjashtimin e gjyqtarit; 10

-numri i kërkesave të parashtruara nga palët për përjashtimin e kryetarit të gjykatës më të ulët; 2

-numri i kërkesave të parashtruara nga gjyqtar i GJSRMV për përjashtimin e gjyqtarit; 127
-numri i kërkesave për përjashtim të parashtruara nga kryetar i gjykatës drejtuar kryetarit të gjykatës më të lartë; 6

Vendime të publikuara, të rregulluara në mënyrë anonime

Publikimi i vendimeve, në faqen zyrtare të gjykatës zhvillohet në vazhdimësi siç është paraparë në Ligjin për udhëheqje me qarkullimin e lëndëve, të shfaqur në tabelën në vijim:

Penale	297
Civile	1043
Në afat të arsyeshëm PSRRG- PSRRK- PSRRU	186
Ankesa në afat të arsyeshëm PSRRZH	129
USPIZH	16
UZZ	6
GJITHSEJ:	1.677

MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Në vitin raportues vëmendje iu përkushtua sidomos informimit të tërësishëm, me rregull dhe në kohë të qytetarëve për punën e Gjykatës me qëllim për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të tyre në drejtim të respektimit dhe zbatimin e sundimit të ligjit dhe ofrimin e sigurisë së drejtë të qytetarëve.

Gjykata vazhdimisht punon në përparimin e transparencës dhe çiltërsisë ndaj qytetarëve duke e vënë në dispozicion praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes publikimit në faqen zyrtare, të qëndrimeve parimore të miratuara, mendimeve juridike parimore dhe konkluzioneve nga Seanca e përgjithshme si dhe mendimet juridike të miratuara për çështje juridike, konkluzionet e nxjerra dhe sentencat nga sektorët në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjatë vitit 2021, në faqen zyrtare të Gjykatës janë publikuar **134 njoftime për publikun** si paralajmërim të Seancave të përgjithshme, seancave të gjyqtarëve, seancave të Sektorit të veprave penale, Sektorit të veprave civile, Sektorit për gjykim në afat të arsyeshëm dhe Sektorit të praktikës gjyqësore, me propozimin e rendit të ditës, si dhe njoftime për miratimin e vendimeve dhe nxjerrjen e konkluzioneve nga Seancat e mbajtura të përgjithshme, seancave të gjyqtarëve dhe seancave të sektorëve të Gjykatës. Gjithashtu, publiku njoftohet edhe për seancat e caktuara publike nga Sektori i veprave penale.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut vazhdimisht publikon njoftime për aktivitetet e kryetarit të Gjykatës dhe pjesëmarrjen në konferenca, në punëtori dhe takime të organizuara në vend dhe jashtë vendit, si dhe informon publikun për mbledhjet dhe vizitat e Gjykatës nga delegacione, përfaqësues të institucioneve dhe për projektet.

Gjithashtu, rregullisht të gjithë kërkesave të palëve dhe përfaqësuesve të medimeve u jepet përgjigje nëpërmjet portalit gjyqësor dhe adresës elektronike të Gjykatës info@vsrm.mk.

Në kuadër të shënimit të Ditës Evropiane të gjyqësorit 25 – Tetorit, në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut u realizua ditë e hapur në Gjykatë me vizitën e nxënësve nga shkolla e mesme profesionale e administratës – juridike.

VIZITA DHE BASHKËPUNIME NDËRKOMBËTARE

Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 18.03.2021 realizoi vizitën e parë protokollare me Shefin e Delegacionit të Bashkimit Evropian, Ambasadorin David Gir në lokalet e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Më 22.04.2021 Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, realizoi takim me Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë SH.T. Fatos Reka.

Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 26.05.2021 realizoi takim protokollar me Ambasadoren e Mbretërisë së Bashkuar SH.S. Rejçell Gallovej.

Më 27.05.2021 Ambasadori i Mbretërisë së Holandës SH.T. Dir Jan Kop, realizoi vizitën e parë protokollare me Kryetaren e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Një delegacion i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e udhëhequr nga Kryetarja e Gjykatës, në periudhën prej 1 deri më 4 shtator, me ftesë të Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Turqisë, mori pjesë në hapjen solemne të Vitit gjyqësor 2021 – 2022 dhe hapjen e objektit të ri të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Turqisë.

Më 20.10.2021 Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, realizoi takim me Ambasadorin Dejvid Gir, Shef i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në të cilin zyrtarisht iu dorëzua Raporti për progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2021.

Më 04.11.2021 Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Z. Robert Spano, realizoi vizitën e parë punuese në Shtet në kuadër të së cilës realizoi takim me Kryetaren dhe me gjyqtarë të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në kuadër të takimeve të përbashkëta të rregullta, Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 21.12.2021, realizoi mbledhje pune me Ambasadorin e Mbretërisë së Holandës SH.T Dir Jan Kop në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kërkesa sipas Ligjit për qasje të lirë në informacione me karakter publik

Numri i kërkesave të pranura

Në periudhën prej 01.01.2021 deri më 31.12.2021, në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë pranuar gjithsej njëzet e nëntë **(29) kërkesa** për qasje të lirë në informacionet me karakter publik. Nga kërkesat e pranura dymbëdhjetë (12) janë parashtruar nga persona juridik përderisa 17 janë parashtruar nga persona fizik.

Për të gjitha kërkesat e pranura për qasje të lirë në informacionet me karakter publik në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë periudhës raportuese është vepruar dhe përgjigjur. Nuk ka kërkesa pa përgjigje.

Në periudhën raportuese në Agjencinë për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacionet me karakter publik është dorëzuar një (1) ankesë nga një person fizik kundër Gjykatës Supreme në lëndë të titulluar kërkesë për qasje të lirë në informacione me karakter publik dhe e njëjta është hedhur poshtë.

Informacione për punën e Zyrës për marrëdhënie me publikun

Zyra për marrëdhënie me publikun pranë Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, jep informacione gjatë rrjedhjes së procedurave që zhvillohen në Gjykatën, në përputhje me ligjet dhe Rregulloren gjyqësore, për çështje të parashtruara nga mediumet kur bëhet fjalë për lëndë që shfaqin interes më të madh te publiku, si dhe të palëve që kanë interes juridik, shpesh përmes telefonit ose në postën elektronike. Me kërkesë të personave të interesuar, Zyra për marrëdhënie me publikun, dorëzon ekzemplarë nga vendimi gjyqësor të publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës, sipas Ligjit për udhëheqjen me qarkullimin e lëndëve në gjykata, megjithatë gjatë vitit nuk është evidentuar asnjë kërkesë nga qytetarë në zyrën.

VENDIMMARJA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në vitin 2021 Gjykata Supreme ka pasur gjithsej në punë **3098** lëndë nga të gjitha llojet, nga të cilat **31** lëndë janë evidentuar përsëri në punë, **2** lëndë udhëhiqen si gabimisht të evidentuara.

Viti ka filluar me **943** lëndë të pakryera nga viti 2020, kurse gjatë vitit janë pranuar **2126** lëndë të reja. Prej tyre të kryera janë **2142** lëndë, kanë mbetur të pakryera **956** lëndë.

Gjatë vitit Gjykata Supreme tërësisht e ka tejkaluar fluksin e lëndëve të reja, por nuk e ka tejkaluar numrin e lëndëve që kanë mbetur të pakryera vetëm për **13** lëndë në nivel të Gjykatës.

Raport sipas sektorëve për periudhën prej datës 01.01.2021 deri më 31.12.2021

Sfera	Sfera civile						
Lloji i lëndës							
Nënllloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Lëndë të ndryshme civile dhe ndeshje të kompetencave të ndryshme	13	94	0	1	106	100	6
Gjithsej – lloji i lëndës	13	94	0	1	106	100	6
Lloji i lëndës	Lëndë civile sipas revizionit						
Nënllloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Konteste ekonomike - revizion	137	309	3	1	448	275	173
Konteste pune – revizion	106	116	1	0	223	160	63
Konteste civile – revizion	384	600	4	0	988	613	375
Gjithsej – lloji i lëndës	627	1025	8	1	1659	1048	611
Gjithsej – sfera	640	1119	8	2	1765	1148	617
Sfera	Sfera penale						
Lloji i lëndës							
Nënllloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Lëndë të ndryshme penale	53	242		0	295	286	9
Mbrojtje e ligjshmërisë sipas lëndëve penale	5	22		0	27	20	7
Zbutje e jashtëzakonshme e dënimit	2	19		0	21	15	6
Gjithsej – lloji i lëndës	60	283	0	0	343	321	22
Lloji i lëndës	Shqyrtimi i jashtëzakonshëm i vendimit të plotfuqishëm						
Nënllloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur

Shqyrtim i jashtëzakonshëm i vendimit të plotfuqishëm krim i organizuar–këshilli prej pesë gjyqtarëve	5	28		0	33	22	11
Shqyrtim i jashtëzakonshëm i vendimit të plotfuqishëm – këshilli prej pesë gjyqtarëve	57	222		0	279	194	85
Gjithsej – lloji i lëndës	62	250	0	0	312	216	96
Lloji i lëndës	Lëndë penale të shkallës së tretë						
Nënllloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Ankesa të aktgjyqimeve në shkallën e tretë	11	50		0	61	55	6
Ankesa të aktvendimeve për paraburgim	4	43		0	47	47	0
Gjithsej – lloji i lëndës	15	93	0	0	108	102	6
Gjithsej - sfera	137	626	0	0	763	639	124
Sfera	Gjykim në afat të arsyeshëm						
Lloji i lëndës	Gjykim në afat të arsyeshëm – të shkallës së dytë						
Nënllloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Gjykim në afat të arsyeshëm - ankesa	38	119	15	0	172	129	43
Gjithsej – lloji i lëndës	38	119	15	0	172	129	43
Lloji i lëndës	Gjykim në afat të arsyeshëm – të shkallës së parë						
Nënllloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Gjykim në afat të arsyeshëm - Administrative	62	95	2	0	159	73	86
Gjykim në afat të arsyeshëm - Penale	31	36	2	0	69	48	21
Gjykim në afat të arsyeshëm - Civile	25	115	2	0	142	81	61
Gjithsej – lloji i lëndës	118	246	6	0	370	202	168
Gjithsej - sfera	156	365	21	0	542	331	211
Sfera	Sfera administrative						
Lloji i lëndës							
Nënllloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Mbrojtja e ligjshmërisë në kontestin administrativ	5	1	0	0	6	6	0
Ankesa kundër vendimeve të Gjykatës Administrative	5	13	1	0	19	16	3
Gjithsej – lloji i lëndës	10	14	1	0	25	22	3
Lloji i lëndës	Ankesa kundër vendimeve të KGJRMV						

Nënlloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Ankesa kundër vendimeve të KGJRMV – për zgjedhje	0	2	1	0	3	2	1
Gjithsej – lloji i lëndës	0	2	1	0	3	2	1
Gjithsej - sfera	10	16	2	0	28	24	4
Gjithsej	943	2126	31	2	3098	2142	956

VËLLIMI DHE VENDIMARRJA SIPAS SEKTORËVE

SEKTORI I VEPRAVE PENALE

Gjyqtarët e Sektorit të veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në vitin 2021 kanë vepruar për lëndët juridiko – penale, me pjesëmarrjen në punën e Seancës së përgjithshme dhe seancave të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, si dhe një numër të konsideruar të aktiviteteve tjera të tyre të orientuara drejt zbatimit më të mirë dhe më efikas të Kushtetutës, të ligjeve dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare me Kushtetutën, aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, si dhe në aktivitetet jashtë lëndëve dhe në vazhdimësi kontribuuan për realizimin më të mirë të rolit të Gjykatës Supreme në ofrimin e sigurimit të barazisë unike të ligjeve nga gjykatat, sidomos kur bëhet fjalë për zbatimin e ligjeve nga sfera e të drejtës penale.

Në Sektorin e veprave penale në vitin 2021 funksionin e gjyqtarit sipas Orarit vjetor të punës të datës 13.01.2021 dhe Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Orarit vjetor të punës së gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore për vitin 2021 të datës 09.04.2021 e kanë realizuar 5 (pesë) gjyqtarë nga të cilët Kryetari i këshillit dhe tre zëvendës anëtarë të këshillit në rast të mungesës ose pengesës së një anëtari të këshillit nuk obligohen me lëndë.

Në Sektorin me Orarin vjetor të punës janë sistemuar 5 (pesë) nëpunës profesional gjyqësor prej të cilëve 1 (një) kryen obligimet e sekretarit të sektorit dhe është caktuar edhe zëvendës për të.

Në sportelin e sektorit ka udhëheqës të sportelit dhe një nëpunës gjyqësor realizues i sportelit.

Pasqyra totale e punës sipas lëndëve

Gjatë vitit raportues **2021** janë pranuar **626** lëndë të reja, **137** lëndë kanë mbetur nga muaji dhjetor i vitit **2020**, ose gjithsej në punë kanë qenë **763** lëndë sipas të gjitha bazave. Gjatë vitit raportues gjyqtarët kanë kryer **639** lëndë, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur të pakryera **124** lëndë nga të gjitha bazat. Sipas të dhënave të theksuara, rritja e numrit të lëndëve **është tejkaluar për 83,74%**, kurse të gjitha **137 lëndët e mbetura** janë kryer në vitin 2021, që tregon se Sektorin e veprave penale në vitin 2021 është absolutisht efikas në veprimin dhe vendimmarrjen.

Pasqyra e gjithsej lëndëve të kryera dhe të pakryera sipas bazave të ndryshme, në vitin 2021 është dhënë në **tabelën në vijim**:

Lloji i lëndëve	Kanë mbetur nga muaji XII 2020	Të pranuar në vitin 2021	Gjithsej në punë	Të kryera	Të pakryera
VKZH1	4	43	47	47	-
VKZH2	11	50	61	55	6

KVP1	-	-	-	-	-
KVP2	57	222	279	194	85
Kvp-KOK1-Kvp	-	-	-	-	-
Kvp-KOK2-Kvp	5	28	33	22	11
VUK	2	19	21	15	6
KZZ	5	22	27	20	7
KR	53	242	295	286	9
GJITHSEJ	137	626	763	639	124

Pjesa totale e lëndëve që kanë mbetur të pakryera në fund të vitit 2021, është për faktin se 47 lëndë janë dërguar për mendim në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë vitit 2021, pasi që nuk janë kthyer në Gjykatë për vendimmarrje deri më 31.12.2021, nga të cilat: VUK-3 lëndë, KVP2-37 lëndë, KVP-KOK2-3 lëndë, VKZH2-2 lëndë dhe KR-2 lëndë.

Struktura e lëndëve të kryera sipas llojit të veprave penale

Struktura e lëndëve të kryera, sipas llojit të veprave penale për kërkesat për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm – **KVP1, KVP2, Kvp.KOK1 dhe Kvp.KOK2**, të gjithsej 216 lëndëve, është si vijon:

Kreu XIV nga Kodi penal

Vepra penale kundër jetës dhe trupit

39 lëndë për vepër penale – Vrasje – **neni 123**;

1 lëndë për vepër penale – Vrasja nga pakujdesia – **neni 126**;

8 lëndë për vepër penale – Lëndimi trupor – **neni 130**;

8 lëndë për vepër penale – Lëndimi i rëndë trupor – **neni 131**;

1 lëndë për vepër penale – Kërcënimi me mjet të rrezikshëm gjatë rrahjes apo përlëshjes – **neni 133**.

Kreu XV nga Kodi penal

Vepra penale kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit

1 lëndë për vepër penale – Keqtrajtimi gjatë kryerjes së detyrës - **neni 143**;

5 lëndë për vepër penale – Rrezikimi i sigurisë – **neni 144**;

1 lëndë për vepër penale – Shkelja e të drejtës së grevës – **neni 156**.

Kreu XIX nga Kodi penal

Vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor

7 lëndë për vepër penale – Dhunimi – **neni 186**;

3 lëndë për vepër penale – Kryerja e aktit seksual me person të paaftë – **neni 187**;

13 lëndë për vepër penale – Sulmi seksual ndaj të miturit që nuk ka mbushur 14 vjet – **neni 188**;

2 lëndë për vepër penale – Kryerja e aktit seksual me keqpërdorim të pozitës – **neni 189**;

1 lëndë për vepër penale – Kënaqja e epsheve seksuale para tjetërkujt – **neni 190**;

1 lëndë për vepër penale – Ekspozimi i materialit pornografik të miturit – **neni 193**;

1 lëndë për vepër penale – Incesti – **neni 194**.

Kreu XX nga Kodi penal

Vepra penale kundër martesës, familjes dhe rinisë

1 lëndë për vepër penale – Marrja e të miturit – **neni 198**;

2 lëndë për vepër penale – Mosdhënia e mjeteve për jetesë – **neni 202**.

Kreu XXI nga Kodi penal

Vepra penale kundër shëndetit të njerëzve

2 lëndë për vepër penale – Mosveprimi sipas dispozitave shëndetësore gjatë kohës së epidemisë – **neni**

70 lëndë për vepër penale – Prodhimi dhe lëshimi në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe pre kursorëve – **neni 215**;

1 lëndë për vepër penale – Mundësimi i përdorimit të drogave narkotike – **neni 216**;

1 lëndë për vepër penale – Vepra të rënda kundër shëndetit të njerëzve – **neni 217**.

Kreu XXIII nga Kodi penal

Vepra penale kundër pronës

1 lëndë për vepër penale – Vjedhja – **neni 235**;

17 lëndë për vepër penale – Vjedhja e rëndë – **neni 236**;

17 lëndë për vepër penale – Grabitja – **neni 237**;

2 lëndë për vepër penale – Vjedhja grabitqare – **neni 238**;

4 lëndë për vepër penale – Fshehja – **neni 239**;

1 lëndë për vepër penale – Dëmtimi i sendeve të huaja – **neni 243**;

1 lëndë për vepër penale – Dëmtimi i të drejtave të huaja – **neni 244**;

2 lëndë për vepër penale – Ndërtimi i paligjshëm – **neni 244-a**;

21 lëndë për vepër penale – Mashtrimi – **neni 247**;

6 lëndë për vepër penale – Shtrëngimi (detyrimi, shantazhi) – **neni 258**;

1 lëndë për vepër penale – Bërja (programimi) dhe futja e viruseve kompjuterike – **neni 251**.

Kreu XXV nga Kodi penal

Vepra penale kundër financave publike, qarkullimit të pagesave dhe ekonomisë

2 lëndë për vepër penale – Kontrabanda – **neni 278**;

3 lëndë për vepër penale – Fshehja e tatimit – **neni 279**;

1 lëndë për vepër penale – Keqpërdorimi i autorizimit në ekonomi – **neni 287**.

Kreu XXVII nga Kodi penal

Vepra penale kundër sigurisë në komunikacionin publik

2 lëndë për vepër penale – Rrezikimi i sigurisë në trafik – **neni 297**;

28 lëndë për vepër penale – Vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pasurisë në trafik – **neni**

300;

1 lëndë për vepër penale – Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësi trafiku – **neni 301**.

Kreu XXVIII nga Kodi penal

Vepra penale kundër shtetit

1 lëndë për vepër penale – Pjesëmarrje në ushtri të huaj, polici, formacione paraushtarake apo para policore – **neni 322-a**;

Kreu XXX nga Kodi penal

Vepra penale kundër detyrës zyrtare

15 lëndë për vepër penale – Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar – **neni 353**;

3 lëndë për vepër penale – Të punuarit e pandërgjegjshëm gjatë detyrës – **neni 353-c**;

1 lëndë për vepër penale – Shpërdorimi i shërbimit – **neni 354**;

4 lëndë për vepër penale – Marrja e rryshfetit – **neni 357**;

Kreu XXXI nga Kodi penal

Vepra penale kundër drejtësisë

1 lëndë për vepër penale – Dhënia e dëshmisë së rrejshme – **neni 367**;

1 lëndë për vepër penale – Moszbatimi i vendimit gjyqësor – **neni 377**.

Kreu XXXII nga Kodi penal

Vepra penale kundër qarkullimit juridik

5 lëndë për vepër penale – Falsifikimi i dokumenteve – **neni 378**

Kreu XXXIII nga Kodi penal

Vepra penale kundër rendit publik

3 lëndë për vepër penale – Pengimi i personit në kryerjen e veprimit zyrtar – **neni 382**;

1 lëndë për vepër penale – Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së punëve të sigurimit – **neni 383**;

11 lëndë për vepër penale – Dhuna – **neni 386**;

1 lëndë për vepër penale – Vetëgjyqësia (arbitrarizmi) – **neni 392**;

2 lëndë për vepër penale – Bashkimi kriminel – **neni 394**;

4 lëndë për vepër penale – Organizata terroriste – **neni 394-a**;

14 lëndë për vepër penale –Përpunimi, mbajtja dhe tregtia e palejuar e armës apo materieve shpërthyesë – **neni 396**.

Kreu XXXIV nga Kodi penal

Vepra penale kundër njerëzimit dhe të drejtës kombëtare

2 lëndë për vepër penale – Tregtia me njerëz – **neni 418-a**;

7 lëndë për vepër penale – Kontrabandë me emigrantë – **neni 418-b**;

3 lëndë për vepër penale – Organizimi i grupit dhe nxitje për kryerje të veprave tregti me njerëz, tregti me person të mitur dhe kontrabandë me emigrantë – **neni 418-c**;

2 lëndë për vepër penale – Tregtia me person të mitur – **neni 418-ç**;

1 lëndë për vepër penale – Keqpërdorimi i regjimit pa viza me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe të Marrëveshjes së Shengenit – **neni 418-d**;

1 lëndë për vepër penale – Marrja e pengjeve – **neni 421**.

Struktura e lëndëve të kryera sipas llojit për kundërvajtje, të evidentuara në Regjistrin -**KR** është si vijon:

58 lëndë – **kundërvajtje nga LSKRR** ;

8 lëndë – **kundërvajtje nga Ligji për rendin dhe qetësinë publike**

1 lëndë - **kundërvajtje nga Ligji për pyjet**;

142 lëndë - **kundërvajtje nga Ligji për automjetet**;

43 lëndë - **kundërvajtje nga Ligji për shoqëritë tregtare**;

1 lëndë – **kundërvajtje nga Ligji për mbrojtjen e konsumatorëve**;

1 lëndë – **kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike**;

1 lëndë – **kundërvajtje nga Ligji për tokën bujqësore**;

1 lëndë – **kundërvajtje nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale**;

13 lëndë - **kundërvajtje nga Ligji për kundërvajtje në komunikacion me pasoja dëmi**;

1 lëndë – **kundërvajtje nga Ligji për tatim**;

1 lëndë - **kundërvajtje nga Ligji për orarin e punës të punëtorëve mobilë në komunikacionin rrugor dhe pajisjet për regjistrim në komunikacionin rrugor**;

1 lëndë – **kundërvajtje nga Ligji për pagesa me para të gatshme**;

1 lëndë – **kundërvajtje nga Ligji për mbrojtjen e popullatës nga sëmundje ngjitëse - rrezikim i vendit**

3 lëndë – **kundërvajtje nga Ligji për marrëdhëniet e punës**.

Nga numri i gjithsej i **216** lëndëve të kryera për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm sipas numrit të lëndëve dhe personave të akuzuar, **gjendja është si vijon**:

	Me 1 person	Me 2 persona	Me 3 persona	Me 4 persona	Me 6 persona	Me 10 persona	GJITHSEJ
KVP1	-	-	-	-	-	-	-
KVP2	175	13	4	1	1	-	194
KVP-KOK1	-	-	-	-	-	-	-
KVP-KOK2	7	11	2	-	-	2	22
Gjithsej	182	24	6	1	1	2	216

Nga numri i gjithsej **216** lëndëve të kryera për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm – **KVP1, KVP2, Kvp.KOK1 dhe Kvp.KOK2** sipas gjykatave të apelit dhe sipas vendimit të këshillit, gjendja është shfaqur në **tabelën në vijim**:

Gjykatat	KVP1, KVP2		KVP-KOK1		KVP-KOK2	
	Të kryera	Të pakryera	Të kryera	Të pakryera	Të kryera	Të pakryera
Gjykata e Apelit Shkup	92	50	-	-	22	11
Gjykata e Apelit Manastir	31	17	-	-	-	-
Gjykata e Apelit Shtip	32	7	-	-	-	-
Gjykata e Apelit Gostivar	39	11	-	-	-	-
GJITHSEJ	216	96	-	-	22	11
					33	

Tregues për kërkesa të refuzuara, të aprovuara, të ndryshuara dhe të hedhura poshtë sipas të gjitha bazave

Gjendja e lëndëve sipas të gjitha bazave, për të cilat kanë vepruar gjyqtarët në Sektorin e veprave penale është shfaqur në **tabelën në vijim:**

Lloji i lëndës	Të refuzuara	Të aprovuara	Në tjetër mënyrë	Të hedhura poshtë	Të kryera	Të pakryera
VKZH1	39	1	-	7	47	-
VKZH2	36	8	1	10	55	6
KVP1	-	-	-	-	-	-
KVP2	115	29	1	49	194	85
VUK	13	-	2	-	15	6
KZZ	9	11	-	-	20	7
KR	1	7	277	1	286	9
Kvp.KOK1	-	-	-	-	-	-
Kvp.KOK2	17	1	-	4	22	11
GJITHSEJ	230	57	281	71	639	124

Gjendja e lëndëve sipas kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë **-KZZ**, të parashtuara nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, që kanë qenë në procedurë në Sektorin e veprave penale, dhe që kanë të bëjnë me gjykatat themelore dhe të apelit është shfaqur në **tabelën si vijon:**

Gjykata e Apelit	Gjykatat themelore dhe numri i lëndëve	Kërkesë e refuzuar	TË APROVUARA							Të kryera	Të pakryera
			I abroguar I aktgjykimi	I abroguar II aktgjykimi	I abroguar aktgjykimi I dhe II	Cenimi I KP	Aktgjykime me lirim	Të hedhura poshtë	Të ndryshuara ose në tjetër mënyrë		
Shkup 12 lëndë	Gjykata Themelore Penale - 6 Gjykata Themelore Veles-2 Gjykata Themelore Gjevgjeli-1 Gjykata Themelore Kavadar-2 Gjykata Themelore Negotinë-1	2	2	4	1	-	-	-	-	9	3
Manastir 4 lëndë	Gjykata Themelore Prilep-1 Gjykata Themelore Manastir-1 Gjykata Themelore Strugë-2	2	-	1	-	-	-	-	-	3	1
Shtip 8 lëndë	Gjykata Themelore Strumicë-1 Gjykata Themelore Koçan-2 Gjykata Themelore Shtip-2 Gjykata Themelore Vinicë-2 Gjykata Themelore Berovë-1	5	1	-	-	-	-	-	-	6	2
Gostivar 3 lëndë	Gjykata Themelore Tetovë-3	-	1	-	-	1	-	-	-	2	1
Gjithsej lëndë në punë: 27 Gjithsej lëndë të kryera: 20		9	4	5	1	1	-	-	-	20	7
1 person	2 persona	3 persona	4 persona	5 persona	Gjithsej persona të akuzuar						
16 lëndë	3 lëndë	-	-	1 lëndë	20						

Dukshëm nga **tabela**, nga gjithsej **20** kërkesat e kryera, **9** janë të refuzuara si të pabaza. Nga **11** lëndët e aprovuara: në **4** lëndë është abroguar vetëm aktgjykimi i shkallës së parë, në **1** lëndë është abroguar aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë, në **1** lëndë është konstatuar cenimi i KP, ndërsa të pakryera kanë mbetur gjithsej **7** lëndë.

Sipas rajonit të apeleve gjendja e lëndëve të kryera apo të pakryera është si vijon: **12** lëndë nga Gjykata e Apelit Shkup, **9** lëndë janë të kryera dhe **3** të pakryera, **4** lëndë nga Gjykata e Apelit Manastir, nga të cilat **3** janë të kryera dhe **1** është e pakryer, **8** lëndë nga Gjykata e Apelit Shtip, nga të cilat **6** janë të kryera dhe **2** janë të pakryera dhe **3** lëndë nga Gjykata e Apelit Gostivar nga të cilat **2** janë të kryera dhe **1** lëndë është e pakryer. Me një person të dënuar ka pasur **16** lëndë, me dy persona **3** lëndë dhe me **5** persona **1** lëndë, ose gjithsej **20** persona të akuzuar.

Gjendja e lëndëve në procedurën e shkallës së tretë – **VKZH1** për ankesa të aktvendimeve për paraburgim dhe për ankesa të aktgjykimeve të Gjykatave të Apelit është shfaqur në **tabelat në vijim**:

VKZH1- ankesa të aktvendimeve për paraburgim

Numri i lëndëve të pranuar edhe në vitin 2021	Kanë mbetur nga muaji 12 i vitit 2020	Lëndë të reja të pranuar	Gjithsej në punë	Të hedhura poshtë	Të refuzuara	Të aprovuara	Në tjetër mënyrë	Të kryera	Të pakryera
47	4	43	47	7	39	1	-	47	-
Gjithsej: 47	4	43	47	7	39	1	-	47	-

VKZH2 – ankesa të aktgjykimeve në shkallën e tretë

Numri i lëndëve të pranuar edhe në vitin 2021	Kanë mbetur nga muaji 12 i vitit 2020	Lëndë të reja të pranuar	Gjithsej në punë	Të hedhura poshtë	Të refuzuara	Të aprovuara	Në tjetër mënyrë	Të kryera	Të pakryera
61	11	50	61	10	36	8	1	55	6
Gjithsej: 61	11	50	61	10	36	8	1	60	6

Sipas ankesave të aktvendimeve për paraburgim – **VKZH1** të pakryera nga viti i kaluar 4 lëndë, të pranuar në vitin 2021 janë **43** lëndë, ose gjithsej në punë ka pasur **47** lëndë, nga të cilat në **39** lëndë ankesa është refuzuar si e pabazë, në **1** lëndë ankesa është aprovuar, ndërsa në **7** lëndë ankesat janë hedhur poshtë.

Sipas ankesave të aktgjykimeve në shkallën e tretë – **VKZH2** të pakryera nga viti i kaluar **11** lëndë, të reja të pranuar në vitin 2021 janë **50** lëndë, ose gjithsej në punë ka pasur **61** lëndë nga të cilat **36** lëndë janë të refuzuara, **8** lëndë janë të aprovuara, **10** lëndë janë të hedhura poshtë, **1** lëndë e kryer në tjetër mënyrë, gjithsej janë kryer **55** lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera **6** lëndë.

Gjendja e lëndëve për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit – **VUK** është si vijon:

Nga viti 2020 kanë mbetur të pa kryera **2** lëndë, në vitin 2021 janë pranuar **19** lëndë të reja, gjithsej në punë kanë qenë **21** lëndë, nga të cilat të kryera janë **15** lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera **6** lëndë. Sipas llojit të vendimit: **13** lëndë janë refuzuar dhe në tjetër mënyrë janë kryer **2** lëndë.

Gjendja e lëndëve të evidentuara si **KR**, ku Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton vendime për ndeshje të kompetencave, për bartjen e kompetencës vendore dhe reale, për parashtrësat e parashtruara nga ana e paditësit në mënyrë subsidijare (plotësuese), për kërkesa të parashtruara për ekstradim, për kërkesa për parashkrim në procedurën për kundërvajtje, për kërkesa të parashtruara për kthimin në procedurën paraprake dhe të tjera, është si vijon:

Nga viti 2020 kanë mbetur **53** lëndë të pakryera, në vitin 2021 janë pranuar **242** lëndë të reja, gjithsej në punë kanë qenë **295** lëndë, nga të cilat **286** lëndë të kryera, ndërsa kanë mbetur të pakryera **9** lëndë. Sipas llojit të vendimit: **1** lëndë është refuzuar, **7** lëndë janë të aprovuara, **1** lëndë është hedhur poshtë dhe **277** lëndë në tjetër mënyrë.

Kohëzgjatja e procedurës për lëndët dhe bazat

Kohëzgjatja e procedurës së lëndëve, në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga pranimi i lëndëve në Sektorin e veprave penale deri në kryerjen dhe dërgimin e tyre është shfaqur në **tabelën si vijon:**

Zgjatja e procedurës për SEKTORIN e veprave penale – 2021

Regjistri	Gjiths ej në punë	Të krye ra	Deri në 1 muaj	Deri në 2 muaj	Deri në 3 muaj	Deri në 4 muaj	Deri në 5 muaj	Deri në 6 muaj	Deri në 7 muaj	Deri në 8 muaj	Deri në 9 muaj	Deri në 10 muaj	Deri në 11 muaj	Deri në 12 muaj	Më shu më se 1 vjet	Të pa krye ra
Regjistri i kërkesave për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit	21	15	2	6	3	2	-	1	-	1	-	-	-	-	-	6
Regjistri për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm - 3																
Regjistri për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm - 5	279	194	8	41	43	22	15	15	16	8	9	5	3	-	9	85
Regjistri për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm – krim i organizuar 3																
Regjistri për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm – krim i organizuar 5	33	22	-	6	8	4	1	2	-	-	-	-	-	-	1	11
Regjistri i ankesave të aktvendimeve të parburgimit	47	47	47	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Regjistri i ankesave të aktgjyqimeve në shkallën e tretë	61	55	13	10	11	5	3	7	3	-	1	-	2	-	-	6
Regjistri i lëndëve të ndryshme penale	295	286	198	53	31	2	1	1	-	-	-	-	-	-	-	9
Regjistri i kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë të lëndëve penale	27	20	2	8	3	3	1	-	1	-	-	-	-	-	2	7
GJITHSEJ	763	639	270	124	99	38	21	26	20	9	10	5	5	-	12	124

Në vitin 2021 siç rezulton edhe nga tabela e kohëzgjatjes së procedurës, sipas numrit të ndarë të lëndëve nuk ka qenë e mundur të veprohet menjëherë për shkak të pengesave administrative, të cilat është duhur të tejkalohen (sigurimi i shkresave, mungesa e shkresave origjinale, rregullimi i dorëzimit të aktgjykimit të shkallës së dytë drejtuar të akuzuarit, provat e dorëzuara në fotokopje, dorëzimi në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të ngjashme).

Disa lëndë, në Gjykatë janë dorëzuar me shkresa të pakompletuara, dhe ka qenë e nevojshme që në mënyrë administrative të kthehen në gjykatat ose në Prokurorinë publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që shkakton angazhimin plotësues të gjyqtarëve referues për kompletimin e lëndëve.

Seancat e Sektorit

Sektori i veprave penale gjatë vitit 2021 në 6 seancat e mbajtura, ka vepruar dhe ka diskutuar për materiale, çështje, iniciativa dhe kërkesa të pranuar, të parashtruara nga gjykatat themelore, të apelit, nga avokatë, nga Byroja për përfaqësimin e RMV në GJEDNJ dhe subjekte të tjera. Në seancat e mbajtura janë nxjerrë 19 konkluzione dhe është miratuar 1 mendim juridik.

SEKTORI I VEPRAVE CIVILE

Sipas Ligjit për gjykatat, Rregullores gjyqësore, Rregullores së punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Programit të punës së Sektorit për vitin 2021 dhe Orarit të punës së Gjykatës për vitin 2021, Sektori i veprave civile gjatë vitit 2021 punoi për lëndët nga sfera e kontesteve civile.

Sektori i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë vitit 2021, obligimet punuese i realizoi sipas kompetencave të përcaktuara në rregullat ligjore të materies në fjalë, me Programin e punës të miratuar nga Sektori i veprave civile, dhe përveç kësaj i realizoi edhe obligimet e parashtruara nga Gjykata. Në Sektorin e veprave civile është vendosur për mjete të parashtruara të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të plotfuqishme gjyqësore, si dhe për lëndë për konfliktin e kompetencave, përcaktimin e një tjetër gjykate kompetente reale, vazhdimin e afatit për parashtrimin e padisë për kontestin e atësisë. Krahas punës për lëndët konkrete, gjyqtarët kanë marrë pjesë në punën e seancave të Sektorit të veprave civile, ku u shqyrtuan çështje aktuale për zbatimin e rregullave ligjore, u miratuan disa mendime juridike dhe konkluzione për çështje të ndryshme kontestuese për zbatimin e punës së Seancës së përgjithshme si dhe u miratuan 6 sentenca. Gjithashtu, gjyqtarët aktivisht morën pjesë në Seancën e përgjithshme në punën e Seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republike të Maqedonisë dhe Seancat e gjyqtarëve të Gjykatës.

Sipas Orarit të punës së gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut të datës 13.01.2021, funksionin e gjyqtarit në Sektorin e veprave civile e realizuan 15 gjyqtarë, që për lëndët vendosën në tre këshilla dhe nëpunës profesional gjyqësor.

Kryetarët e këshillave nuk obligohen me lëndë.

Në Sektorin nga radhët e nëpunësve profesional është caktuar sekretar i Sektorit dhe zëvendës i tij.

Me Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të datës 13.01.2021 të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021, të miratuar më 09.04.2021, në Sektorin e veprave civile u sistemuan 13 gjyqtarë në dy këshilla dhe bashkëpunëtorë profesional gjyqësorë.

Kryetarët e këshillave, nuk obligohen me lëndë.

Me Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të datës 13.01.2021, 09.04.2021 dhe 27.05.2021, me Orarin vjetor të punës së gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021, të miratuar më 31.08.2021, Sektori ka punuar me 12 gjyqtarë.

Krahas kësaj, gjyqtarët nga Sektori i veprave civile me Orarin e punës së gjyqtarëve dhe të administratës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, morën pjesë edhe në punën e sektorëve tjerë të Gjykatës. Në fakt, gjyqtarë individual morën pjesë në vendimmarrjen e kërkesave për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm dhe në këshillin e shkallës së dytë që vendos për ankesat kundër aktvendimeve të këshillit prej tre gjyqtarëve mbi kërkesat për gjykim në afat të arsyeshëm; në punën e Sektorit dhe këshillit të veprave penale; në punën e Këshillit të specializuar që do të vendos për ankesat e kandidatit që nuk është zgjedhur për gjyqtar; në Këshillin e specializuar për vendimmarrjen e ankesave kundër vendimeve të Gjykatës Administrative nga neni 62 të Ligjit për konteste administrative, me propozim për mbrojtjen për shkak të veprimit të paligjshëm; në punën e Sektorit të praktikës gjyqësore, së bashku me bashkëpunëtorët profesional gjyqësor.

Në sportelin e Sektorit të veprave civile në vitin 2021 kanë punuar udhëheqësi i sportelit dhe 2 nëpunës gjyqësor – realizues në sportelin.

Struktura e lëndëve

Nga treguesit numëror për vitin 2021, në Sektorin e veprave civile ka pasur **në punë gjithsej 1.765 lëndë**, nga të cilat 18 lëndë të pakryera kanë mbetur nga viti 2020, 2 lëndë të pakryera nga viti 2019, ndërsa **të reja të pranuar janë 1126 lëndë**.

Në vitin 2021 në Sektorin e veprave civile rritja e numrit të lëndëve të reja është tejkaluar, përkatësisht në vitin 2021 **janë pranuar gjithsej 1126 lëndë** ndërsa **janë kryer gjithsej 1148 lëndë**, në mënyrë që **rritja e numrit është tejkaluar** për 22 lëndë. Në vitin 2021 numri i lëndëve **që kanë mbetur të pakryera është zvogëluar për 13 lëndë**, përkatësisht nga 640 lëndë që kanë mbetur në fund të vitit 2020, në vitin 2021 në fund të vitit kanë mbetur 617 lëndë të pakryera.

Raporti vjetor i qarkullimit të lëndëve – Civile, viti 2021

Sfera	Sfera civile						
Lloji i lëndës							
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Lëndë të ndryshme civile dhe ndeshje të kompetencave të ndryshme	13	94	0	1	106	100	6
Gjithsej – lloji i lëndës	13	94	0	1	106	100	6
Lloji i lëndës	Lëndë civile sipas revizionit						
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Konteste tregtare – revizion	137	309	3	1	448	275	173
Konteste pune – revizion	106	116	1	0	223	160	63
Konteste civile – revizion	384	600	4	0	988	613	375
Gjithsej – lloji i lëndës	627	1025	8	1	1659	1048	611
Gjithsej - sfera	640	1119	8	2	1765	1148	617

Struktura e 1148 lëndëve të kryera është si vijon: nga Regjistri Rev1 – janë kryer 275 lëndë; nga Regjistri Rev2 – janë kryer 613 lëndë; nga Regjistri Rev3 – janë kryer 160 lëndë; nga Regjistri R – janë kryer 100 lëndë.

Struktura e 617 lëndëve të pakryera është si vijon: 2 lëndë kanë mbetur të pakryera nga viti 2019 nga Regjistri Rev2, për arsye që lënda e parë është dërguar administrativisht në Gjykatën Themelore dhe ende nuk është kthyer, ndërsa lënda e dytë është lëndë lidhur me përsëritjen e procedurës. Nga viti 2020 kanë mbetur 2 lëndë të pakryera nga Regjistri Rev1, nga Regjistri Rev2 kanë mbetur të pakryera 13 lëndë dhe nga Regjistri Rev3 kanë mbetur 3 lëndë të pakryera. 597 lëndët tjera të pakryera janë nga viti 2021 edhe atë nga Regjistri Rev1 – 171 lëndë të pakryera, nga Regjistri Rev2 – 360 lëndë dhe nga Regjistri Rev3 kanë mbetur 60 lëndë të pakryera, nga Regjistri R kanë mbetur 6 lëndë të pakryera. Gabimisht të evidentuara janë 2 lëndë, 1 lëndë nga Regjistri R dhe 1 lëndë nga Regjistri Rev1.

Lëndë të pakryera sipas vitit të pranimit	Të pranuar në vitin 2019	Të pranuar në vitin 2020	Të pranuar në vitin 2021	Gjithsej
Regjistri i lëndëve civile sipas revizionit	2	13	360	375
Regjistri i kontesteve tregtare sipas revizionit	0	2	171	173
Regjistri i kontesteve të punës sipas revizionit	0	3	60	63
Regjistri i lëndëve të ndryshme civile	0		6	6
Gjithsej	2	18	597	617

Mënyra e kryerjes së lëndëve

Procedura e revizionit si mjet i jashtëzakonshëm juridik, shfrytëzohet nga palët për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre. Nga gjithsej numri i **1.765** lëndëve që kanë qenë në punë në vitin 2021 sipas revizionit ka pasur **1.659** lëndë, nga të cilat nga Regjistri **Rev1 – 448** lëndë, nga Regjistri **Rev2 – 988** lëndë dhe nga Regjistri **Rev3 – 223** lëndë, përkatësisht sipas revizionit ka pasur **94 %** nga gjithsej numri i lëndëve, ndërsa nga këta sipas revizionit janë **1048** lëndë të kryera, përkatësisht 63,17%.

Lloji i lëndës	Lëndë civile sipas revizionit						
Nënllloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Konteste tregtare – revizion	137	309	3	1	448	275	173
Konteste pune – revizion	106	116	1	0	223	160	63
Konteste civile – revizion	384	600	4	0	988	613	375
Gjithsej – lloji i lëndës	627	1025	8	1	1659	1048	611

Nga numri i 1048 lëndëve, përmbajtja e vendimeve të revizionit duket kështu: të refuzuara 579 respektivisht 55,25 %, të ndryshuara 74 respektivisht 7,06%, të abroguara 167 respektivisht 15,94%, të hedhura poshtë 223 respektivisht 21,28%, të kryera në tjetër mënyrë 5 respektivisht 0,47%.

Gjykatë	Të hedhura poshtë	Të refuzuara	Të ndryshuara	Të abroguara	Të kryera në tjetër mënyrë	Gjithsej
Shkup	129	361	48	104	3	645
Manastir	39	88	17	25	1	170
Shtip	17	57	4	17		95
Gostivar	35	73	5	21	1	135
Administrative	3					3
Gjithsej	223	579	74	167	5	1048

Gjendja në gjykatat e apelit lidhur me **revizionet e refuzuara** në vitin 2021, është kështu:

Gjykatë	Gjithsej revizione të kryera	Revizione të refuzuara	Përqindja e revizioneve të refuzuara
Shkup	645	361	55,97
Manastir	170	88	51,77
Shtip	95	57	60,00
Gostivar	135	73	54,07
Administrative	3	0	0
Gjithsej	1048	579	55,25

Gjendja e gjykatave të apelit lidhur me revizionet e aprovuara me **vendime të ndryshuara** në vitin 2021, është si vijon:

Gjykatë	Gjithsej revizione të kryera	Vendime të ndryshuara	Përqindja e revizioneve të ndryshuara
Shkup	645	48	7,44
Manastir	170	17	10,00
Shtip	95	4	4,22
Gostivar	135	5	3,70
Administrative	3	0	0
Gjithsej	1048	74	6,11

Gjendja e gjykatave të apelit lidhur me revizionet e aprovuara me **vendime të abroguara** në vitin 2021, duket kështu:

Gjykatë	Gjithsej revizione të kryera	Vendime të abroguara	Përqindja e revizioneve të abroguara
Shkup	645	104	16,12
Manastir	170	25	14,71
Shtip	95	17	17,89
Gostivar	135	21	15,56
Administrative	3	0	0
Gjithsej	1048	167	14,22

Gjendja e gjykatave të apelit lidhur me **revizionet e hedhura poshtë** në vitin 2021, është si vijon:

Gjykatë	Gjithsej revizione të kryera	Revizione të hedhura poshtë	Përqindja e revizioneve të hedhura poshtë
Shkup	645	129	20,00
Manastir	170	39	22,94
Shtip	95	17	17,89
Gostivar	135	35	25,92
Administrative	3	3	100,00
Gjithsej	1048	223	23,09

Gjendja e gjykatave të apelit lidhur me **revizione të kryera në tjetër mënyrë** në vitin 2021, është si vijon:

Gjykatë	Gjithsej revizione të kryera	Të kryera në tjetër mënyrë	Përqindja e revizioneve të hedhura poshtë
Shkup	645	3	0,47
Manastir	170	1	0,58
Shtip	95	0	0
Gostivar	135	1	0,75
Administrative	3	0	0
Gjithsej	1048	5	0,47

Procedura tjera

Sektori i veprave civile përveç mjeteve të jashtëzakonshme juridike, ka vendosur edhe për lëndë tjera nga kompetenca e tij. Ato janë, lëndë për konfliktin e kompetencave, përcaktimi i një gjykate tjetër reale vendore, vazhdimi i afatit për parashtrimin e padisë për kontestimin e atësisë, nga të cilat në punë kanë qenë gjithsej 106 lëndë dhe nga këto janë kryer 100 lëndë, ose 94,34%, ndërsa kanë mbetur të pakryera 6 apo 5,66%.

Nënllloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Lëndë të ndryshme civile dhe konflikte të ndryshme të kompetencave	13	94	0	1	106	100	6
Gjithsej-lloji i lëndës	13	94	0	1	106	100	6

Struktura e lëndëve sipas bazave juridike

Dukshëm nga bazat juridike në revizionet për të cilat është vendosur në Sektorin e veprave civile gjatë vitit 2021, mund të konstatohet ndryshueshmëri. Të shumta janë lëndët sipas bazës për **kompensim të dëmit 284 lëndë** ose 27,10%, pastaj sipas bazës **borxhi – 257 lëndë** ose 24,52%, për **pronësia dhe zotërimi – 183 lëndë** ose 17,46%; **konteste pune – 155 lëndë** ose 14,79%; **shfuqizimi dhe ndërprerja e marrëveshjes – 65 lëndë** ose 6,20%; për **arritja pa bazë – 34 lëndë** ose 3,24%; për **asistencë – 67 lëndë** ose 3,05%; për **falimentim – 21 lëndë** ose 2,00%, dhe **të drejtat e autorit dhe pronësia industriale – 17 lëndë** ose 1,62%.

Baza	2021
Asistenca	67
Kompensim i dëmit	284
Arritja pa bazë	34
Shfuqizimi dhe ndërprerja e marrëveshjes	65
Borxhi	257
Pronësia dhe zotërimi	183
Konteste pune	155
Falimentimi	21
Të drejtat e autorit	17
Gjithsej	1048

Zgjatja e procedurës

Në vitin 2021 nga gjithsej 1.148 lëndët e kryera, zgjatje të procedurës me mbi tre vjet ka pasur në 3 lëndë; nga 1 deri në 3 vjet ka pasur 249 lëndë; nga 8 muaj deri në 1 vjet në 308 lëndë; nga 06 deri në 8 muaj në 113 lëndë; nga 3 deri në 6 muaj ka pasur në 242 lëndë; nga 2 deri në 3 muaj në 72 lëndë, nga 1 deri në 2 muaj në 101 lëndë, deri në 1 muaj procedura ka zgjatur në 60 lëndë.

Zgjatja e procedurës	Të kryera	Deri në 1 muaj	Nga 1 deri në 2 muaj	Nga 2 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 6 muaj	Nga 6 deri në 8 muaj	Nga 8 deri në 1 vjet	Nga 1 deri në 3 vjet	Mbi 3 vjet
Regjistri i lëndëve civile të revizionit	613	1	33	36	142	61	196	143	1
Regjistri i kontesteve tregtare të revizionit	275	8	30	19	60	30	58	68	2
Regjistri i lëndëve të ndryshme civile	100	49	32	8	9	1	0	1	0
Regjistri i kontesteve të punës të revizionit	160	2	6	9	31	21	54	37	0
Gjithsej	1148	60	101	72	242	113	308	249	3

Seanca e Sektorit

Gjatë vitit 2021 Sektori i veprave civile, mbajti **5 seanca**. Në këto seanca është shqyrtuar për çështje të ndryshme juridike që rezultojnë nga lëndët dhe çështjet juridike dhe çështjet e parashtruara nga gjykatat themelore dhe të apelit dhe nga parashtrues të tjerë, për të cilët janë miratuar **5 mendime juridike**, të cilat janë publikuar në faqen zyrtare dhe **6 sentenca të miratuara dhe të publikuara**. Në Sektorin e veprave civile është vepruar për **90 lëndë të ndryshme civile** të evidentuara me shenjë Gr për çështje të parashtruara juridike.

SEKTORI PËR GJYKIM NË AFAT TË ARSYESHËM

Sipas Ligjit për gjykatat, Rregullores së punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Orarit të punës së gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore për vitin 2021, gjyqtarët nga **Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm** gjatë **vitit 2021** kanë vepruar për lëndët e formuara për kërkesat e parashtruara për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm dhe ankesat kundër aktvendimeve të këshillave prej 3 gjyqtarëve për kërkesat për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.

Krahas punës për lëndët konkrete nga Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm dhe në seanca të Sektorit, ku ishin shqyrtuar çështje aktuale dhe janë nxjerrë konkluzione për çështje juridike me kuptim të veprimit të këshillave dhe unifikimin e praktikës së Gjykatës Supreme me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjyqtarët morën pjesë në punën e lëndëve në Sektorin civil dhe penal si dhe në Sektorin e praktikës gjyqësore. Gjithashtu, gjyqtarët morën pjesë në punën e Seancës së përgjithshme dhe seancat e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, si dhe në aktivitete tjera të orientuara kah zbatimin më efikas i Kushtetutës, ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara me Kushtetutën, aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në aktivitete jashtë lëndore të orientuara drejt përmirësimit të rolit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në Sektorin për gjykim në afat të arsyeshëm me Orarin vjetor të punës së gjyqtarëve dhe të administratës gjyqësore në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 të datës **13.01.2021**, funksionin e gjyqtarit e realizuan gjithsej **17 (shtatëmbëdhjetë)** gjyqtarë.

Me Orarin vjetor të punës së gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 të datës 13.01.2021, u formuan **3 (tre) këshilla** për vendimmarrjen e kërkesave për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm në shkallën e parë.

Për vendimmarrjen e **ankesave** kundër aktvendimeve të këshillit prej 3 gjyqtarëve për kërkesat për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, sipas Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat (neni 36-a), u caktua **këshilli prej pesë gjyqtarëve dhe është caktuar zëvendës anëtar i këshillit**.

Me Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për Orarin vjetor të punës së gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 të datës **09.04.2021** dhe Vendimin për korigjimin e Vendimit për Orarin e punës të gjyqtarëve dhe të administratës gjyqësore në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 të

datës **12.04.2021** në këtë Sektor janë sistemuar gjithsej **11 (njëmbëdhjetë)** gjyqtarë dhe u formuan **2 këshilla** për vendimmarrjen e kërkesave për mbrojtjen e të drejtave për gjykim në afat të arsyeshëm në shkallën e parë. Kryetarët e të dy këshillave nuk obligohen me lëndë. Gjyqtarët e sistemuar në Sektorin për gjykim në afat të arsyeshëm i kanë vendosur lëndët nga të gjitha materiet. Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për Orarin e punës së gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 të datës 27.05.2021 dhe 31.08.2021 janë caktuar zëvendës anëtarë të këshillit ankimor, në raste të pengesës dhe mungesës për shkaqe të arsyeshme të një anëtarit të këshillit.

Në Sektorin për gjykim në afat të arsyeshëm në shkallën e parë dhe të dytë kanë vepruar 18 nëpunës profesional gjyqësor. Është caktuar edhe sekretar i Sektorit dhe zëvendës i tij.

Në vitin raportues punën e sportelit të Sektorit për gjykim në afat të arsyeshëm, në të dyja shkallët e ka realizuar vetëm 1 nëpunës gjyqësor – Udhëheqës i sportelit.

Pasqyra totale e punës së lëndëve

Sektorin për gjykim në afat të arsyeshëm, gjatë vitit raportues **2021, gjithsej në punë** ka pasur **542** lëndë, në të dyja shkallët e vendimmarrjes, nga të cilat **365 lëndë të reja të pranuar**, ndërsa nga periudha e kaluar raportuese kanë mbetur **të pakryera 156** lëndë, përderisa përsëri në punë ka pasur **21** lëndë. Gjatë vitit raportues janë kryer **331** lëndë, ndërsa **211 lëndë kanë mbetur të pakryera**.

Para këshillave të shkallës së parë në punë ka pasur **370** lëndë, nga të cilat **246** lëndë të reja të pranuar, ndërsa **118** lëndë kanë mbetur të pakryera nga periudha e kaluar raportuese, përderisa **6** lëndë kanë qenë përsëri në punë. Këshillat e para në periudhën raportuese kanë kryer **202** lëndë, përderisa **168** lëndë kanë mbetur të pakryera.

Këshilli i shkallës së dytë gjithsej në punë ka pasur **172** lëndë nga të cilat **119** lëndë të reja të pranuar, ndërsa **38** lëndë kanë mbetur të pakryera nga periudha e kaluar raportuese, ndërsa **15** lëndë kanë qenë përsëri në punë. Në fund të periudhës raportuese këshilli i shkallës së dytë ankimor ka kryer **129** lëndë, ndërsa **43** lëndë kanë mbetur të pakryera.

Tabela e shfaqur e numrit të lëndëve në këtë Sektor për vitin 2021

Sfera	Gjykim në afat të arsyeshëm						
Lloji i lëndës	Gjykim në afat të arsyeshëm – të shkallës së parë						
Nënllloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Gjykim në afat të arsyeshëm - Administrative	62	95	2	0	159	73	86
Gjykim në afat të arsyeshëm – Penale	31	36	2	0	69	48	21
Gjykim në afat të arsyeshëm – Civile	25	115	2	0	142	81	61
Gjithsej – lloji i lëndës	118	246	6	0	370	202	168
Lloji i lëndës	Gjykim në afat të arsyeshëm - të shkallës së dytë						
Nënllloji i lëndës	Të pa kryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Gjykim në afat të arsyeshëm – ankesa	38	119	15	0	172	129	43
Gjithsej – lloji i lëndës	38	119	15	0	172	129	43
Gjithsej – sfera	156	365	21	0	542	331	211

Nga numri i gjithsej **331 lëndëve të kryera në periudhën raportuese**, në **167 lëndë** – kërkesa për mbrojtjen e të drejtave për gjykim në afat të arsyeshëm **është refuzuar** si e pabazë, në **106 lëndë** – kërkesa për mbrojtjen e të drejtave për gjykim në afat të arsyeshëm **është aprovuar**, përderisa në **58 lëndë** – kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm **është hedhur poshtë**.

Mënyra e vendimmarrjes – afat të arsyeshëm 2021

Tituj	Të hedhura poshtë	Të refuzuara	Të aprovuara	Në tjetër mënyrë	Të reja të pranuar	Të pakryera në fund të periudhës	Të kryera	Të pakryera nga periudha e kaluar	Gjithsej në punë
PSRRG	18	32	31		117	61	81	25	142
PSRRK	10	12	26		38	21	48	31	69
PSRRU	11	40	22		97	86	73	62	159
PSRRZH	19	83	27		134	43	129	38	172
GJITHSEJ	58	167	106		386	211	331	156	542

Nëpunësit gjyqësor në sportelin e Sektorit, në realizimin e obligimeve të tyre punuese, profesionalisht bashkëpunojnë me të gjithë gjyqtarët dhe këshilltarët gjyqësorë. Në mënyrë profesionale, të përgjegjshme, të disiplinuar dhe të përditësuar, kryenin të gjitha detyrat administrative që nga pranimi i kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, evidentimi, formimi i lëndës, dorëzimi i aktvendimit të shkallës së parë, formimi i lëndës për ankesën, dërgimi i shkresave dhe urgjencave drejtuar kryetarëve të gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe dërgimi i njoftimit drejtuar Buxhetit gjyqësor të RM, në rastet e konstatimit të shkeljes së të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm dhe dhënien e një kompensimi të caktuar në para.

Pasqyra totale e punës së lëndëve të këshillave të shkallës së parë

Gjatë vitit **2021**, këshillat e shkallës së parë në punë ka pasur **370 lëndë** ose **68,27 %** nga gjithsej **542 lëndë** në Sektorin.

Numrin total të **370 lëndëve** në punë e përbëjnë **252 lëndë** të reja të pranuar dhe **118 lëndë** që kanë mbetur të pakryera nga periudha e kaluar raportuese. Në këshillat e shkallës së parë janë kryer gjithsej **202 lëndë** ose **54,59%**, përderisa të **pakryera** në fund të vitit raportues kanë mbetur **168 lëndë** ose **45,41 %**.

Mënyra e vendimmarrjes - afat të arsyeshëm shkalla e I, viti 2021

Tituj	Të pa kryera nga periudha e kaluar	Të reja të pranuar	Gjithsej në punë	Të kryera	Të hedhura poshtë	Të refuzuara	Të aprovuara	Në tjetër mënyrë	Të pa kryera në fund të periudhës
PSRRG	18	32	31	117	61	81	25		142
PSRRK	10	12	26	38	21	48	31		69
PSRRU	11	40	22	97	86	73	62		159
GJITHSEJ	39	84	79	252	168	202	118		370

Mund të konstatohet se nga **202 lëndët e kryera**, mbizotëron numri i lëndëve të kryera në këshillin e shkallës së parë, në të cilat kërkesa për mbrojtjen e të drejtave për gjykim në afat të arsyeshëm është **refuzuar si e pabazë** edhe atë në **84 lëndë** ose **41,58 %**, nga të cilat mbizotëron numri i lëndëve nga materia **administrative 40** ose **47,62 %**, pastaj vijojnë lëndët nga materia **civile 32** ose **38.09 %** dhe **12 lëndë** ose **14.29 %** nga materia **penale**.

Nga **202 lëndët e kryera** në këshillat e shkallës së parë, **79 lëndë** ose **39,11 %**, janë përfunduar me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, nga të cilat mbizotëron numri i lëndëve të **materies civile – 31** ose **39,24%**. Numri i lëndëve nga materia **penale** që janë kryer me **miratimin** e kërkesës dhe konstatimin e shkeljes për të drejtën për gjykim në afat të

arsyeshëm numëron **26 lëndë** ose **32,91%**, përderisa numri i lëndëve nga **materia administrative** që janë kryer me miratimin e kërkesës dhe konstatimin e shkeljes së të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm numëron **22** ose **27,85%**.

Nga **202 lëndët e kryera** në këshillat e shkallës së parë, në **39 lëndë** ose **19.31%**, kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm është **hedhur poshtë**. Në këtë mënyrë mbizotërojnë lëndë nga materia **civile 18** ose **46.15%** pastaj vijojnë lëndë të materies **penale 10** lëndë ose **25.64%** dhe **11 lëndë** nga materia administrative ose **28.21%**.

Analiza e numrit të lëndëve të kryera në këshillat e parë dhe parametrat e kërkesave të miratuara, të refuzuara dhe të hedhura poshtë në periudhën raportuese, tregojnë se mbizotëron numri i lëndëve **të kryera me refuzimin** e kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, sidomos në lëndët nga **materia administrative**. I konsiderueshëm është edhe numri i **168 lëndëve** ose **45.41%** që kanë mbetur të pakryera, ku mbizotërojnë lëndët nga **materia administrative – 86 lëndë** ose **51.19%**, në krahasim me **61 lëndë** ose **36.31%** janë nga **materia civile** dhe **21 lëndë** ose **12.5%** nga **materia penale**.

Duke i marrë parasysh parametrat të cilat i vlerëson këshilli gjatë vendimmarrjes për një lëndë konkrete për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, siç janë lënda e ndërlikuar, kohëzgjatja e procedurës, sjellja e palëve në procedurë dhe sjellja në gjykatën që ka vepruar, shkeljet më të shpeshta të procedurës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm që ka përfunduar me miratimin e kërkesës mund të konstatojmë te **lëndët civile**, ndërsa një numër i madh i lëndëve që kanë mbetur në punë janë nga **materia administrative**, ndërsa për shkak të dorëzimit jo në kohë ose mos kompletimit të shkresave për lëndët.

Zgjatja e procedurës në këshillat e shkallës së parë

Në këshillat e shkallës së parë janë kryer **202 lëndë**, në të cilat kohëzgjatja e procedimit për kërkesat e deklaruara për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, e përfshin periudhën nga pranimi i lëndës, deri në dërgimin e aktvendimit të shkallës së parë parashtruesit të kërkesës.

Zgjatja e procedurës – Gjykim në afat të arsyeshëm për vitin 2021 shkalla e I

	Gjithsej në punë	Të kryera	Deri në 1 muaj	Deri në 2 muaj	Deri në 3 muaj	Deri në 6 muaj	Mbi 6 muaj	Kanë mbetur për punë
PSRRU	159	73	3	4	7	18	41	86
PSRRG	142	81	1	8	7	39	26	61
PSRRK	69	48	1	2	5	12	28	21
GJITHSEJ	370	202	5	14	19	69	95	168

Nga gjithsej 202 lëndët e kryera të shkallës së parë ose 54,59% nga të cilat

- në periudhën deri në 1 muaj, janë kryer 5 lëndë ose 2,48% nga të cilat: PSRRU - 3 lëndë, PSRRG – 1 lëndë, PSRRK – 1 lëndë
- në periudhën deri në 2 muaj janë kryer 14 lëndë ose 6,93% nga të cilat: PSRRU – 4 lëndë, PSRRG – 8 lëndë, PSRRK – 2 lëndë
- në periudhën deri në 3 muaj janë kryer gjithsej 19 lëndë ose 9,40% nga të cilat: PSRRU – 7 lëndë, PSRRG – 7 lëndë, PSRRK – 5 lëndë
- në periudhën deri në 6 muaj, janë kryer gjithsej 69 lëndë ose 34,16%, nga të cilat: PSRRU – 18 lëndë, PSRRG – 39 lëndë, PSRRK – 12 lëndë
- në periudhën prej më shumë se 6 muaj, janë kryer 95 lëndë ose 47,03% nga të cilat: PSRRU – 41 lëndë, PSRRG – 26 lëndë dhe PSRRK – 28 lëndë
- në vitin 2021 kanë mbetur për punë 168 lëndë ose 45,41 %, nga të cilat: PSRRU – 86 lëndë, PSRRG – 61 lëndë dhe PSRRK – 21 lëndë.

Shkak për tejkalimin e afatit prej **6 muajve** si kornizë ligjore për kryerjen e këtij lloji të lëndëve në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kurse dukshëm nga numri i **168 lëndëve** të pakryera, kryesisht është mungesa e shkresave të lëndëve, për të cilat ka të bëjë kërkesa. Në fakt, pas evidentimit të kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm dhe formimin e lëndës, obligim i gjyqtarit – referues është që t'i kërkojë me shkrim – me urgjencë shkresat e lëndës nga gjykata në të cilën është zhvilluar procedura. Duke marrë parasysh të theksuarën, rrjedh prononcimi i vonuar i gjyqtarëve, të cilët veprojnë me lëndët, përkatësisht numri i madh i lëndëve të pakryera në këshillin e parë edhe krahas urgjencave të shumta të dërguara për dorëzimin e shkresave për kërkesën e

parashtruar në gjykatën, e cila ka vepruar për lëndën konkrete, për të cilën ka të bëjë kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.

Në këtë kontest, mungon mjeti juridik, me të cilin Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, do t'i imponojë gjykatat më të ulëta për dorëzimin më të shpejtë të shkresave të lëndës, veçanërisht në rastet kur lënda për të cilën ka të bëjë kërkesa për mbrojtjen e të drejtave për gjykim në afat të arsyeshëm është lëndë aktive, përkatësisht lëndë që është në rrjedhë, ku vlen rregulli për tu krijuar kushte që procedura e lëndës të vazhdojë në fazën, në të cilën gjendet dhe të mos e pres vendimmarrjen e kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm. Pamundësia, që në të gjitha rastet të respektohet afati prej **6 muajsh** për vendimmarrjen e kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm vërehet në çdo periudhë - vit raportues të deritanishëm. Ky konstatim, ka qenë lëndë diskutimi edhe në seancat e Sektorëve, ku janë nxjerrë konkluzione përkatëse, të cilat vet në vete nuk mund të japin rezultat, nëse sipas sistemit nuk janë në dispozicion edhe për shqyrtimin e rregullave të procesit për vendimmarrjen e këtij lloji të lëndës, si dhe objektivitetin e kornizës së vendosur ligjore, e cila nuk korrespondon me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njerëzve. Në fakt, me kornizën ligjore prej **6 (gjashtë) muajsh** dhe mos krijimin e kushteve të procesit për përshpejtimin e procedurës, përkatësisht, vendimmarrjen e lëndëve në atë afat edhe në të dyja shkallët e vendimmarrjes në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, vet më vete do të thotë dhënia e mundësisë palëve – kërkuessve për tu ankuar edhe për zgjatjen e procedurës në këtë Gjykatë.

Pamundësia e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në të gjitha rastet për ta respektuar afatin – kornizën prej **6 (gjashtë) muajsh** për përfundimin e procedurave të kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, nënkuptojnë edhe obligim për shqyrtimin e afatit ligjor, në kontekst të konsistencës së procedurës në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njerëzve dhe praktikën e kësaj gjykate. Në këtë kontekst, përsëri potencohet obligimi i kryetarëve të gjykatave, për tu angazhuar për dorëzimin e shkresave të lëndëve, për të cilat bëhet vlerësimi i procedimit në afat të arsyeshëm, e tërë kjo me qëllim që Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, që të mund të respektojë afatin për gjykim në afat të arsyeshëm, duke marrë parasysh se pasojat e veprimit jo në kohë të duhur sipas detyrimit për dorëzimin e shkresave të lëndëve, të cilat nevojiten për veprimin e kërkesave për gjykim në afat të arsyeshëm, reflektohet në procedimin e tërësishëm për këto lëndë në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e me këtë edhe të vlerësimit të efikasitetit për mjetin juridik. Me kuptim të ndjekjes së efikasitetit të mjetit juridik është të insistohet përmes kryetarëve të gjykatave, që me kohë të jepen të dhëna për respektimin e afateve që janë dhënë nga kjo gjykatë për kryerjen e lëndëve që janë në rrjedhë, në fazë të procesit të vendimmarrjes, për të cilën ka të bëjë kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.

Pasqyra totale e punës së lëndëve në këshillin e shkallës së dytë

Gjatë vitit **2021**, këshilli i ankesave të shkallës së dytë gjithsej në punë ka pasur **172** lëndë ose **31.73%** nga gjithsej numri i **542** lëndëve në këtë Sektor.

Gjithsej numrin e **172** lëndëve e përbëjnë **134** lëndë të reja të pranuar ose **77.91 %** dhe **38** lëndë ose **22.09%** që kanë mbetur të pakryera nga periudha e kaluar raportuese. Këshilli i shkallës së dytë në periudhën raportuese ka kryer **129** lëndë ose **75%** përderisa **43** lëndë ose **25%** kanë mbetur të pakryera.

Mënyra e vendimmarrjes – afat të arsyeshëm për vitin 2021, shkalla e II

Të hedhura poshtë	Të refuzuara	Të aprovuara	Në tjetër mënyrë	Të reja të pranuar	Të pakryera në fund të periudhës	Të kryera	Të pa kryera nga periudha e kaluar	Gjithsej në punë
-------------------	--------------	--------------	------------------	--------------------	----------------------------------	-----------	------------------------------------	------------------

Këshilli i shkallës së dytë, gjatë vitit **2021 ka kryer 129** lëndë ose **75%** nga gjithsej 172 lëndët e kryera në këtë Sektor, nga të cilat:

Në **83** lëndë ose **64,34%** ankesa është **e refuzuar** si e pabazë,

Në **27** lëndë ose **20,93%** ankesa është **e aprovuar** dhe

Në **19** lëndë ose **14,72%** ankesa është **hedhur poshtë**,

Analiza e gjithsej numrit të lëndëve të kryera, në këshillin e shkallës së dytë sipas strukturës tregon tendencë të periudhës relativisht të shkurtër, të veprimit me lëndët respektivisht mbizotëron numri i lëndëve të kryera, ndërsa parametrat e kërkesave të aprovuara, të refuzuara dhe të hedhura poshtë, në periudhën raportuese tregojnë se mbizotëron numri i lëndëve – të kryera me refuzimin e ankesës si të pabaza respektivisht me **konfirmimin e aktvendimit të shkallës së parë** në gjithsej **83** lëndë.

Zgjatja e procedurës në këshillin e shkallës së dytë

Zgjatja e procedurës, në këshillin e shkallës së dytë në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kompetente për vendimmarrjen e ankesave të deklaruara kundër aktvendimeve të shkallës së parë, përfshin periudhën nga pranimi i ankesës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, deri në dërgimin e aktvendimit të shkallës së dytë parashtruesit të kërkesës.

Zgjatja e procedurës – afat të arsyeshëm për vitin 2021, shkalla e II

Titulli	Gjithsej në punë	Të kryera	Deri në 1 muaj	Deri në 2 muaj	Deri në 3 muaj	Deri në 6 muaj	Mbi 6 muaj	Kanë mbetur për punë
PSRRZH	172	129	5	20	35	59	10	43
GJITHSEJ	172	129	5	20	35	59	10	43

Nga gjithsej numri i **172** lëndëve në punë në këshillin e ankesave të shkallës së dytë, janë kryer gjithsej **129** lëndë ose **75%**, nga të cilat:

- për periudhën deri në **1** muaj procedura ka përfunduar në **5** lëndë ose **3.88%**,
- për periudhën deri në **2** muaj procedura ka përfunduar në **20** lëndë ose **15.50%**,
- për periudhën deri në **3** muaj procedura ka përfunduar në **35** lëndë ose **27.13%**,
- për periudhën deri në **6** muaj procedura ka përfunduar në **59** lëndë ose **45.74%**,
- për periudhën me mbi **6** muaj procedura ka përfunduar në **10** lëndë ose **7,75%**,
- kanë mbetur për punë në vitin **2021 - 43** lëndë ose **25%**.

Analiza e kohës për kryerjen e lëndëve në këshillin e ankesave, tregon **respektimin relativ të afatit prej 6 muajsh**, si kornizë ligjore për vendimmarrjen e lëndëve edhe në të dyja shkallët e vendimmarrjes në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo, veçanërisht sepse gjatë procedimit të kornizës ligjore prej 6 muajsh nuk është marrë parasysh koha e nevojshme për dorëzimin e lëndëve të kryera në shkallën e parë drejtuar palëve dhe rrjedhja e afatit për ankesë. Nga këtu, koha e vendimmarrjes së lëndëve në këshillin e ankesave të marrë vetëm për vete determinon se, afati për procedimin sipas këtij lloji të lëndëve në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është jo konsekuente me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njerëzve.

Kompensimi i drejtë

Nga gjithsej **331** lëndët e kryera të këtij Sektori, nga të cilët **202** lëndë në shkallën e parë dhe **129** lëndë në shkallën e dytë, për të cilat është marrë vendim në Sektorin për gjykim në afat të arsyeshëm, në vitin **2021**, shuma **maksimale** e shqiptuar në emër të kompensimit të drejtë, për shkak të cenimit të së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, në këshillat e shkallës së parë në **62** kërkesa të aprovuara numëron **4.27.000** denarë dhe ka të bëjë për më shumë parashtrues, të cilët të drejtën e tyre për gjykim në afat të arsyeshëm e kanë realizuar me një kërkesë, përderisa shuma e shqiptuar **minimale** në **këshillat e shkallës së parë** është **1.000** denarë. **Shuma maksimale** e shqiptuar në emër të kompensimit të drejtë është për shkak të cenimit të së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm **në**

këshillin e ankesave të shkallës së dytë, në **22** ankesa të **aprovuara**, numëron **40.000** denarë, ndërsa shuma **minimale** në emër të kompensimit të drejtë nga ana e shkallës së dytë numëron **10.000** denarë.

Nga **331** lëndët e kryera në këtë Sektor, në vitin **2021** në **shkallën e parë** është shqiptuar kompensim i drejtë në vlerë prej **2.925.900** denarë, kurse në **këshillin e shkallës së dytë** kompensimi i shqiptuar është **480.875** denarë ose shuma totale në të dyja shkallët e vendimmarrjes prej **3.406.775** denarë, në emër të kompensimit të drejtë, ashtu edhe për shpenzimet e procedurës për kërkesat e parashtruara për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.

Seanca e Sektorit

Në seancat e Sektorit për gjykim në afat të arsyeshëm, janë shqyrtuar çështje të rëndësishme juridike, të cilat burojnë nga lëndët e formuara të kërkesave për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, dhe njëkohësisht janë shqyrtuar edhe raportet mujore të punës së këshillave të këtij Sektori. Gjatë vitit 2021, Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm mbajti 4 – (katër) seanca, në të cilat janë nxjerrë 9 (nëntë) konkluzione.

SEKTORI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

Sipas Ligjit për gjykatat, Rregullores gjyqësore, Rregullores së punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Programit të punës së Sektorit të praktikës gjyqësore për vitin 2021 dhe Vendimin për Orarin vjetor të punës së gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021, Sektori i praktikës gjyqësore gjatë vitit 2021 ka punuar në realizimin e qëllimit themelor, prioritetet dhe orientimet në unifikimin e zbatimit të ligjit dhe ndjekjen e praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sipas Vendimit të Orarit vjetor të punës së gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 03Su.nr.10/2021 të datës 13.01.2021, në Sektorin e praktikës gjyqësore u sistemuan 11 gjyqtarë, kryetarë të sektorëve dhe kryetarë të këshillave dhe 10 nëpunës profesional gjyqësor, sekretarë të sektorëve dhe zëvendës të tyre. Me Orarin është caktuar sekretar i praktikës gjyqësore dhe zëvendës i tij.

Sipas Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për Orarin vjetor të punës së gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021, 03Su.nr.10/2021 të datës 13.01.2021, të miratuar më 09.04.2021 si 03Su.nr.302/21, në Sektorin e praktikës gjyqësore u sistemuan 4 gjyqtarë dhe 5 nëpunës profesional gjyqësorë dhe sekretarë të sektorëve.

Vëllimi dhe cilësia e punës

Sektori i praktikës gjyqësore, në kuadër të punës së tij të rregullt, ka mbajtur **4 seanca** gjatë vitit 2021.

Njëkohësisht, Sektori i praktikës gjyqësore mbajti edhe takime pune në të cilat u diskutua për mundësitë dhe mënyrën e evidentimit dhe kërkimit të praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe për nevojën për elektronik të re, bazë të brendshme për të dhënat.

Në realizimin e qëllimit themelor – ndjekjen në vazhdimësi dhe unifikimin e praktikës gjyqësore gjatë vitit 2021, qëndrimet parimore dhe mendimet juridike parimore të miratuara në Seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, mendimet juridike dhe konkluzione të sektorëve të specializuar dhe sentenca të pranuar të këshillave, i evidentoi me sistematizimin e sferave juridike dhe i publikoi në faqen zyrtare të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në pjesën e praktikës gjyqësore.

Gjatë vitit 2021, në faqen zyrtare të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, janë publikuar shtatë (7) mendime juridike parimore, një (1) qëndrim parimor, gjashtë (6) mendime juridike, njëzet e një (21) konkluzione, njëzet e dy (22) sentenca, për të cilat është dhënë treguesi në tabelë.

Mendime juridike parimore	7	<ul style="list-style-type: none"> - Lejueshmëria e ankesës kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë me të cilin është vërtetuar aktvendimi i noterit si përfaqësues të gjykatës - Lejueshmëria e revizionit në konteste për përgjegjësi civile për ofendim dhe për shpifje - Kompetenca e këshillit penal për zhdëmtimin e fëmijës që është viktimë e veprës penale/ kundërvajtje me elemente të dhunës - Prishja e marrëveshjes për punësim, për shkaqe personale, kur punëtori nuk i plotëson kushtet për kryerjen e punës dhe parashkrimi - Masa e përkohshme - Lejueshmëria e revizionit - Lejueshmëria e revizionit në procedurat për mbrojtjen nga diskriminimi
Qëndrime parimore	1	<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut
Mendime juridike	6	<ul style="list-style-type: none"> - Mënyra e përfitimit të pronësisë së automjetit motorik - Kompetenca e këshillit për vlerësim të aktakuzës sipas nenit 336 paragrafi (3) të LPP - Parashkrimi i kërkesës së kontributeve të SPIMV - Shënimi i urdhëresës për përmbarrim në certifikatën e pasurisë mbi patundshmëritë e debitorit të falimentimit para hapjes dhe të drejtës së veçuar - Vendosja e Gjykatës revizore për të dhënat e cituara të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale - Ndërprerja e procedurës së zbatimit kur pala është person juridik mbi të cilin është ngritur procedurë e falimentimit
Konkluzione	21	<ul style="list-style-type: none"> - Konkluzion i Seancës së përgjithshme - Dënimi për tentim të veprës penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 236 paragrafi (5) në lidhje me paragrafin (1) pika 1 të Kodit penal - Shënimi zyrtar nuk është provë në procedurë në gjykatë - Prezenca e të dëmtuarit në seancën e gjykatës së shkallës së parë - Zbatimi i ligjit që është më i butë për të akuzuarin dhe parimi in dubio pro reo - Veprimi mbi kërkesat shtesë të dorëzuara për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm - Nocioni “publik” të vepra penale “Dhuna” nga neni 386 të KP - Caktimi i shpenzimeve në procedurën penale - Mbajtja e seancës në Gjykatën e Apelit në procedurën për kundërvajtje - Mbajtja e seancës publike në gjykatën e shkallës së dytë - Kompetenca e Komisionit pranë MPB, sipas nenit 88 paragrafi (1) dhe paragrafi (2) të Ligjit për automjetet - Obligimi i të akuzuarit për kompensim të dëmit dhe me kërkesë juridike pronësore nga neni 353 të KP - Plotësimi i përshkrimit të ngjarjes juridike penale në kumtimin e aktgjykimit - Zbatimi i nenit 108 paragrafi (1) të KP për parashkrimin e ndjekjes penale - Organi kompetent për vendosjen e garancisë së theksuar në ankesën e paraburgimit - Konkluzione lidhur me aktgjykim të GJEDNJ Sinadinovska kundër RMV - Konkluzion të Seancës së përgjithshme - Konkluzion të Seancës së përgjithshme - Kërkesa e shkresave të lëndës - Kompensimi i drejtë në shumën të veçuar - Shpenzimet e procedurës

Sentenca	<p>22</p> <ul style="list-style-type: none"> - E drejta e kompensimit për zyrtarizmin e krijuar - Përjashtimi i përgënjeshtimit të dhuratave nga falënderimi – barrë e dëshmisë - Përgjegjësia solidare e themeluesit për obligimet e një institucioni - Transformimi i marrëdhënies së punës nga koha e caktuar në kohë të pacaktuar - Deklarata e të dëmtuarit të dhënë para Prokurorit Publik në hetim - Kompetenca në kontestet e pavlefshmërisë së dispozitave nga vendimi dhe protokollit që formojnë marrëdhënie juridiko – pronësore dhe marrëdhënie tjera juridiko - civile - Lejueshmëria e revizionit në procedurën për pranimin e vendimit të huaj gjyqësor - Barabarësia e mjeteve dhe procedura kundërthënëse - Diskriminimi i të dëmtuarës/viktimë e veprës penale - Llogaritja e shpenzimeve në procedurë penale - Deklaratat e dëshmitarëve gjatë njohjes - Ri ekspertimi për vlerësimin e besueshmërisë të deklaratës së fëmijës së dëmtuar - "Detyrimisht" pranimi i fajit - Tërheqja e deklaratës për pranimin e fajit - Pranimi i fajit me saktësimin e aktakuzës - Konfiskimi i pronës dhe dobisë pronësore - Personi përgjegjës në personin juridik - Mungesa e lëndimeve fizike dhe trupore te vepra penale "Dhunimi" - Organi kompetent për vendimmarrjen për paraburgim pas abrogimit të aktgjykimit të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë. - Kërkesa e palejuar për KVP pa autorizim nga i akuzuari te mbrojtësi sipas detyrës zyrtare - Paanësia e gjyqtarit - Llogaritja e afatit në orë
----------	--

Gjatë vitit 2021, Sektori i praktikës gjyqësore bëri përzgjedhjen, evidentimin dhe sistematizimin e sferave juridike të vendimeve të miratuara me rëndësi juridike (vendime të rëndësishme) këshillave gjykues të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në dosjen "Praktika gjyqësore", që paraqet bazën e brendshme të dhënave në dispozicion për të gjithë gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional gjyqësor të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Njëkohësisht nga Sektori i praktikës gjyqësore janë ndjekur vendime të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe me qëllim për unifikimin e praktikës gjyqësore u realizua kërkimi i vendimeve të ngjashme apo identike në bazën e të dhënave që e ka Sektori i praktikës gjyqësore, në Programin AKMIS përmes sporteleve dhe faqes zyrtare të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në të cilën publikohen vendimet e rregulluara anonime të Gjykatës.

Sektori i praktikës gjyqësore, gjatë vitit 2021 ka vepruar në 28 lëndë, të evidentuara nën SPR numër, të cilat janë formuar sipas kërkesave të parashtruara për miratimin e qëndrimeve parimore dhe mendimeve juridike parimore, për çështje me kuptim të sigurimit të unitetit me zbatimin e ligjeve nga gjykatat, për kërkesa të parashtruara që kanë të bëjnë me krahasimet në zbatimin e ligjeve nga gjykatat në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe unifikimin e praktikës gjyqësore edhe me shkresat e dorëzuara nga Ministria e Drejtësisë, Byrosë për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njerëzve, lidhur me praktikën gjyqësore dhe lëndët të cilat janë kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut zhvillohen në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njerëzve në Strasburg.

Sektori i praktikës gjyqësore, e ndoqi praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg përmes analizës së vendimeve dhe seleksionimin e tyre me qëllim të implementimit të tyre më lehtë në vendimet e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Aktgjykimet e miratuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut,

janë përditësuar aktualisht në nëndosjet përkatëse në dosjen "Praktika gjyqësore e GJEDNJ" e krijuar në dosjen ekzistuese "Praktika gjyqësore", në atë mënyrë që janë në dispozicion të brendshëm për gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional gjyqësorë.

Aktivitete tjera

Gjatë vitit 2021, përfaqësues të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, morën pjesë në Takimin punues të gjykatave të apelit për harmonizimin e praktikës gjyqësore, të mbajtur më 06 tetor 2021, në Shkup.

PUNA E SEANCËS SË PËRGJITHSHME, TË GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Sipas Ligjit të gjykatave, në plotësim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, kryetari dhe të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, morën pjesë në punën e Seancës së përgjithshme.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë vitit **2021** ka mbajtur **27 Seanca të përgjithshme** në të cilat janë shqyrtuar shumë çështje:

- Është miratuar Programi i punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022.

- Seanca e përgjithshme shqyrtoi 32 (tridhjetë e dy) iniciativa për miratimin e qëndrimeve parimore dhe mendimeve juridike parimore.

- Është diskutuar për 3 (tre) çështje juridike.

- Është miratuar 1 (një) qëndrim parimor.

- Janë miratuar 7 (shtatë) mendime juridike parimore.

- Janë dhënë 5 (pesë) mendime pozitive sipas ligjeve.

- Është miratuar Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Janë emëruar anëtarë të 10 (dhjetë) Këshillave për vendimmarrjen e ankesave kundër vendimeve të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Seanca e përgjithshme diskutoi për 4 (katër) kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

- Është miratuar Raporti i punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2020.

- Në Seancë të përgjithshme të zgjeruar janë shqyrtuar Raportet e punës së gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2020.

- Janë miratuar Vlerësimet dhe konkluzionet e raporteve për punën e gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2020.

- Seanca e përgjithshme, me kërkesë të mendimit nga Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut për numrin orientues të lëndëve që secili gjyqtar duhet ti kryejë në muaj për shkak të miratimit të Vendimit për normën orientuese për vitin 2021, dha propozim mendim se gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk duhet të obligohen me normë orientuese.

- Janë emëruar dy anëtarë dhe zëvendës të tyre për Këshillin e Programit të Akademisë së gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, edhe atë njëri anëtar dhe zëvendësi i tij nga radha e gjyqtarëve të gjykatave më të ulëta ose nga Gjykata Administrative përkatësisht Gjykata e Lartë Administrative.

- Është dhënë mendim pozitiv me propozim Metodologjia me indikatorë për caktimin e lëndëve të ndërlukuara të dorëzuar nga Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa i përpunuar nga Qendra për hulumtime dhe analiza juridike në kuadër të projektit nga ambasada e Holandës.

- Seanca e përgjithshme ka vendosur me kërkesë për përjashtimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Seanca e përgjithshme ka vendosur për përjashtimin edhe të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga Këshilla për vendimmarrjen e ankesave kundër vendimeve të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për përjashtimin e anëtarëve të Këshillave për vendimmarrjen kundër vendimeve të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Është shqyrtuar kërkesa për lëndën OSZH.

- Është diskutuar për kërkesën e dorëzimit të procesverbalit nga seanca publike për lëndën OSZH.

- Është shqyrtuar dhe diskutuar për kërkesën e dorëzuar dhe nënshkruar nga një Anëtar i Këshillit gjyqësor – Koordinator për Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Është diskutuar mbi Aktvendimin e Këshillit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vendimmarrjen e ankesave.
- Është diskutuar mbi 4 (katër) Konkluzione të nxjerra në Seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Është siguruar mendim për ndryshimin dhe plotësimin e Orarit vjetor të punës së gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021.
- Është siguruar mendim për Orarin vjetor të punës së gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022.
- Seanca e përgjithshme ka dhënë 5 (pesë) mendime me kërkesë të kryetarit të gjykatës për sistemimin e gjyqtarëve nga një sektor në tjetër.
- Vendosi për 13 (trembëdhjetë) kundërshtime të gjyqtarëve kundër vendimeve për Orarin vjetor të punës së kryetarëve të gjykatave.
- Vendosi për 2 (dy) kundërshtime të gjyqtarëve kundër vendimeve të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

SEANCA TË GJYQTARËVE

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë vitit **2021** ka mbajtur **3 Seanca të gjyqtarëve** në të cilat janë shqyrtuar si vijon:

- Dhënia e mendimit për propozimin e Metodologjisë me indikatorë për konstatimin e lëndëve të ndërlukuara të dorëzuar nga Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa i përpunuar nga Qendra për hulumtime dhe analiza juridike në kuadër të projektit të mbështetur nga ambasada e Holandës.
- Njohja me aktivitetet e grupit punues në lidhje me Ligjin e rrogave të gjyqtarëve.
- Njohja me aktivitetet e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën e ardhshme.

QENDRA E INFORMATIKËS

Në Qendrën e informatikës, së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është vendosur pajisje harduerike – softuerike e tërësishme nga sfera e IKT dedikuar për funksionimin papengesë të GJSRMV dhe një pjesë për gjykatat e RMV dhe KGJRMV. Plotësuese në Qendrën e informatikës janë vendosur baza të caktuara të centralizuara për të dhënat, funksionalitetin e centralizuar, këmbimin e të dhënave të centralizuara me institucione nga jashtë etj., që dedikohen për punën papengesë për të gjitha gjykatat. Aktivitetet themelore për funksionimin papengesë për implementimin e sistemit IKT (planifikimin, pjesëmarrjen në projekte IKT zhvilluese, administrimin, menaxhimin, monitorimin, mbrojtjen, sigurinë, prokurime publike të centralizuara, përkrahja e shfrytëzuesve etj.) janë në perimetër të detyrave punuese të gjithsej 4 (katër) IKT inxhinierëve të punësuar në Qendrën e informatikës së GJSRMV.

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në funksion janë aplikacionet e shfrytëzuesve nga sfera e IKT me tendencë të rritjes së tyre në periudhën e ardhshme siç vijon:

- Aplikacioni për administrimin e procesionit të lëndëve gjyqësore (AKMIS).
- Aplikacioni për punën financiare dhe materiale (ABMS).
- Aplikacioni për publikimin e praktikës gjyqësore, të Gjykatës Supreme të RMV dhe vendime të gjykatave të apelit në Ueb faqen për praktikën gjyqësore.
- Aplikacioni për publikimin e vendimeve gjyqësore, informacioneve, informacione të reja, të dhëna statistikore e të dhëna tjera të faqes zyrtare të Gjykatës Supreme të RMV.
- Vendosja e centralizuar të Ueb Portalit gjyqësor dhe WEB portaleve së të gjitha gjykatave të RMV.
- Sistemi i postës elektronike dedikuar për të punësuarit në Gjykatën Supreme të RMV dhe për njoftimin e shfrytëzuesve të sistemit për Dorëzimin elektronik të dokumenteve gjyqësore
- Aplikacioni për dorëzimin elektronik të dokumenteve gjyqësore (faza e parë – dorëzimi nga gjykatat te shfrytëzuesit), dedikuar për të gjitha gjykatat e RMV, me bazë të centralizuar për të dhënat e vendosura në Gjykatën Supreme të RMV.
- Aplikacioni i evidencës ndëshkuese e dedikuar për të gjitha gjykatat e RMV, me bazë të centralizuar të vendosur në Gjykatën Supreme të RMV.
- Backup (kopje) të centralizuar të AKMIS bazave nga të gjitha gjykatat e RMV.

- Servisi i centralizuar për këmbimin e të dhënave të drejtorëve të falimentimit me Regjistër Qendror të RMV, dedikuar për të gjitha gjykatat e RMV.
- Servisi i centralizuar për këmbimin e të dhënave ndërmjet gjykatave dhe prokurorive të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Servisi i centralizuar për këmbimin e të dhënave ndërmjet gjykatave dhe Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Servisi i centralizuar për dhënien elektronike të vërtetimeve nga baza e evidencës ndëshkuese përmes sistemit të ndërvepruesmërisë të MIOA

IKT inxhinierët e punësuar në Qendrën e informatikës, së Gjykatës Supreme të RMV, gjatë vitit 2021 kanë realizuar aktivitetet në vijim:

- Konstatimin e nevojave, përpunimin e specifikimit teknik të detajuar dhe kriteret për konstatimin e aftësisë, pjesëmarrjen në evoluim dhe realizimin (dhënia e përkrahjes teknike dhe ndjekja e përparimit në përputhje me planet e nënvizuara me afat) e procedurave për prokurim publik, të cilat i përfshijnë nevojat e të gjitha gjykatave të RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV nga sfera e IKT siç vijon:
 1. Mirëmbajtja harduerike – softuerike të pajisjes, të siguruar në kuadër të projektit IPA2010 kryesisht mirëmbajtjen preventive dhe adaptuese të ueb faqeve së të gjitha gjykatave të RMV dhe të Këshillit gjyqësor të RMV
 2. Mirëmbajtja adaptuese dhe preventive e sistemit AKMIS të implementuar në gjykatat e Republikës së Maqedonisë së Veriut kryesisht edhe mirëmbajtja e aplikacioneve plotësuese dhe servisimi integruar në të njëjtin
 3. Mirëmbajtjen e Platformës IBM Lotus Domino, sistemin e – mail dhe aplikacionin ueb për publikimin e vendimeve nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të RMV
 4. Mirëmbajtjen harduerike – softuerike dhe parapagesën vjetore të softuerit të Firewall Check Point arkitekturën e implementuar në të gjitha gjykatat e RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV.
 5. Mirëmbajtjen harduerike – softuerike dhe parapagesën vjetore softuerike të VMware infrastrukturën e implementuar në të gjitha gjykatat e RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV.
 6. Furnizimi me licenca për pako softuerike të integruar për antivirus të tërësishëm dhe mbrojtje kundër bllokues për nevojat e sistemit gjyqësor të RMV
 7. Mirëmbajtjen e softuerit për grumbullimin, analizën dhe kërkimin e shënimeve log të pajisjeve të IKT të vendosura në GJSRMV
 8. Mirëmbajtjen e post – garancisë së sistemit për klimatizimin preciz në sistem sallën e Gjykatës Supreme të RMV
 9. Furnizimi me materialet AOP për nevojat e Gjykatës Supreme të RMV
 10. Furnizimi me shërbimet konsultative për analiza dhe përgatitje të specifikimeve teknike për furnizimin e serverëve të rinj dhe pajisjeve tjera në të gjitha gjykatat e RMV
 11. Furnizimi me serverë të rinj dhe pajisje tjetër IKT për funksionimin e sistemit AKMIS me të gjitha mbindërtimet
 12. Pjesëmarrje në Grupin punues të formuar nga Këshilli gjyqësor të RMV për përpunimin e specifikimit teknik dhe kriterëve për konstatimin e aftësive në procedurën për furnizimin e internet lidhjeve për të gjitha gjykatat e RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV
- Ndjekja e vazhdueshme e gjendjes dhe marrja e aktiviteteve adekuate për funksionimin papengesë të aplikacioneve të implementuar, të shfrytëzuesve, të dedikuara për GJSRMV dhe një pjesë për të gjitha gjykatat e RMV, në të gjitha fazat e zbatimit të tyre:
 - o Vërejtjen e pengesave të paraqitura, probleme të papritura, vërejtje dhe korrespondenca me përgatitësin e aplikacionit shfrytëzues për mënjanimin e tyre.
 - o Perceptimi i nevojave eventuale nga mbindërtimi dhe përmirësimi
 - o Ndarja adekuate e të drejtave të shfrytëzuesve dhe privilegjet
 - o Mbështetja teknike e shfrytëzuesve të brendshëm dhe të jashtëm të cilët drejtohen në Qendrën e informatikës dhe kërkojnë ndihmë
 - o Përpunimi i raporteve të ndryshme statistikore për nevojat e shërbimeve gjyqësore dhe institucionet tjera
- Planifikimi i mjeteve të nevojshme financiare për investimin dhe mirëmbajtjen në sferën IKT për të

gjitha gjykatat e RMV dhe KGJRMV, planifikimin e nevojshëm për edukimin e vazhdueshëm të kuadrove IKT të punësuar në gjykatat e RMV dhe planifikimi i nevojshëm për punësime të reja të kuadrove profesionale IKT në Qendrën e informatikës së Gjykatës Supreme të RMV.

- Administrimi gradual, menaxhimi dhe ndjekja e sistemeve IKT të cilat janë të vendosura në Qendrën e informatikës së Gjykatës Supreme të RMV, të dedikuara për Gjykatën Supreme të RMV dhe një pjesë për të gjitha gjykatat e RMV.
- Realizimi i përditshëm dhe kontrollimi i procedurave për mbrojtjen e të dhënave sistemuere dhe shfrytëzuesve (backup), të dedikuara për Gjykatën Supreme të RMV dhe një pjesë për të gjitha gjykatat e RMV.
- Monitorimin e logo sistemeve për paraqitjen e gabimeve të pajisjes së tërësishme të IKT, të vendosur në Qendrën e informatikës të Gjykatës Supreme të RMV, me qëllim për mënjanimin eventual të problemeve që hasen.
- Ndjekja në vazhdimësi e performancave të sistemeve IKT, të vendosura me qëllim për marrjen e aktiviteteve përkatëse ose pasqyrimin e nevojave për përmirësimin e tyre.
- Mirëmbajtja në vazhdimësi dhe administrimi i stacioneve punuese, notebook, kompjuterëve, printerëve, skanerëve.
- Bashkëpunimin dhe koordinimin e Qendrës së informatikës të GJSRMV me sektorë të informatikës të gjykatave në RMV dhe KGJRMV, me qëllim të dhënies së rekomandimeve dhe udhëzimeve për marrjen e aktiviteteve të caktuara lidhur me funksionet e centralizuar, njoftimet për mirëmbajtjen e sigurt të sistemeve IKT të caktuara, procedura për lajmërimin e problemeve të shfaqura, dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm etj.
- Ndjekja e vazhdueshme e teknologjive dhe trendëve të reja në sferën e IKT (pa edukim adekuat) duke shfrytëzuar literaturë që është në dispozicion në Internet.
- Udhëheqja me dokumentacion të rregullt për realizimin e aktiviteteve sistemuere dhe shfrytëzuese, probleme të shfaqura, mënjanimin e tyre, udhëheqjen me raporte mujore për realizimin e detyrave punuese të IKT inxhinierëve nga Qendra e informatikës së GJSRMV dhe të ngjashme.
- Pjesëmarrja në punën e Këshillit për koordinimin e teknologjisë informatike – komunikuese në organet e gjyqësorit, pjesëmarrja në takime pune për planifikimin dhe realizimin e projekteve IPA, pjesëmarrja në takime pune duke përfshirë edhe përpunimin dhe dorëzimin e të dhënave të nevojshme drejtuar ekspertëve të angazhuar në kuadër të projekteve për mbështetjen e reformave në gjyqësor, pjesëmarrja në Grupin punues për përshtatjen e Rregullores gjyqësore me rregullat e vlefshme ligjore etj.
- Sipas të gjitha trendëve shoqërore bashkëkohore, imponohet nevoja për futjen e vazhdueshme të teknologjive të reja informatike dhe sistemeve IKT në sistemin gjyqësor të RMV, që të mundet përmes teknologjisë informatike bashkëkohore, edukative, kompatible dhe unifikuese të arrihet qëllimi përfundimtar, realizimi i lidhshmërisë efikase në të gjitha gjykatat e territorit të RMV dhe këmbimi i të dhënave me institucione tjera. Ajo, me automatizëm dhe dukshëm e zmadhon vëllimin e punës së vetëm 4 (katër) IKT inxhinierëve që janë në Qendrën e informatikës pranë GJSRMV.

Adekuatë për të, është evidente dhe e domosdoshme nevoja për punësimin e vazhdueshëm të IKT inxhinierëve profesional në Qendrën e informatikës, të cilëve do t'iu mundësohet edukim i vazhdueshëm dhe adekuat duke marrë parasysh se teknologjia e informatikës është sistemi më dinamik në çdo shoqëri bashkëkohore.

RESURSE NJERËZORE

Me Vendim të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është përcaktuar që funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ta kryejnë **28 gjyqtarë**. Megjithatë si edhe vitet e kaluara edhe këtë vit gjyqtarit i cili është zgjedhur për anëtar i Këshillit gjyqësor, vendi i gjyqtarit pezullohet.

Në korrik 2021, një gjyqtari i është shqiptuar masë, përkohësisht largimi nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit deri në përfundimin e plotfuqishëm të procedurës për konstatimin e përgjegjësisë.

Në periudhën nga 31.12.2021 deri më 31.01.2026 një gjyqtari me kërkesë të tij i është caktuar pezullimi i funksionit të gjyqtarit.

Nga e sipër ekspozuara rezulton se, Gjykata në vitin raportues ka funksionuar me përbërje të paplotë të gjyqtarëve me vetëm 18 gjyqtarë që ishte madje edhe në kufi të minimumit të nevojshëm për funksionimin normal të Gjykatës, duke marrë parasysh kompetencat e saj, punën e Seancës së përgjithshme, punën e katër sektorëve, Sektorit të veprave penale, Sektorit të veprave civile, Sektorit për

gjykim në afat të arsyeshëm dhe Sektorit të praktikës gjyqësore, që shkakton një numër të konsideruar të përjashtimeve dhe nevojën për riorganizimin dhe ri sistemimin me angazhim të vazhdueshëm edhe të bashkëpunëtorëve profesional gjyqësor në disa këshilla.

Sipas Ligjit për gjykatat, Ligjit për shërbim gjyqësor, Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe Planit vjetor për punësim është caktuar organizimi i brendshëm, vendet e punës dhe numri i realizuesve të nevojshëm për realizimin e kompetencave të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nga numri i paraparë i nëpunësve gjyqësor në Rregulloren, që sipas Ligjit për shërbim gjyqësor klasifikohen në tre grupe (nëpunës udhëheqës, profesional dhe nëpunës ndihmës profesional gjyqësor), mund të konstatohet se numri i nëpunësve gjyqësor në gjykatë fare nuk i përmbush nevojat sipas vëllimit dhe ndërlikimit të kompetencës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut si gjykatë më e lartë e shtetit.

Në periudhën e kaluar konstatohet derdhja dhe zbrazja e vendeve të punës nga të gjitha kategoritë e nëpunësve gjyqësor për shkak të largimit në institucione tjera, shpërngulje dhe me bazë të pensionimit.

Duke qenë se ashtu vendet e zbrazura të punës nuk janë plotësuar me kohë, për shkak të mospranimit të miratimit dhe pëlqimit nga Ministria e financave për publikimin e shpalljeve, mungesa nga të punësuarit kompensohet me orarin e punës, që një periudhë të gjatë kohore çdo i punësuar kryen disa punë.

Sipas Ligjit të transferimit të nëpunësve administrativ, të punësuar nëpërmjet programit K-5 në Ministrinë e sistemit politik dhe marrëdhënieve ndërmjet bashkësive dhe Planit për transferimin e nëpunësve administrativ të pa sistemuar, të punësuar nëpërmjet programit K-5 të miratuar në seancën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, me aktvendim për udhëzim të përhershëm nga Ministria e sistemit politik dhe marrëdhënieve ndërmjet bashkësive, në qershor 2021, 3 (tre) persona janë punësuar në Gjykatën Supreme në kohë të pacaktuar nga të cilët 2 (dy) në vendet të punës bashkëpunëtorë më të ri gjyqësorë dhe 1 (një) në vendin e punës bashkëpunëtor të ri.

Në dhjetor 2021 pas pranimit të pëlqimit, janë realizuar 7 (shtatë) avancime të nëpunësve gjyqësorë me publikimin e shpalljes së brendshme, ndërsa në rrjedhë është procedura për punësimin e 5 nëpunësve gjyqësorë me publikimin e shpalljes publike edhe atë për vendin e punës Udhëheqës i njësisë për punë financiare dhe materiale 1 (një) realizues, për vendin e punës Këshilltarë i pavarur gjyqësor 3 (tre) realizues dhe për vendin e punës Këshilltar i pavarur gjyqësor 1 (një) realizues.

Nëse merret parasysh edhe periudha e kaluar me vendet e zbrazura të punës me bazë për pensionim, për shkak të largimit në institucione tjera tregon se numri i nëpunësve gjyqësor në Gjykatë fare nuk i përmbush nevojat. për momentin, në tre sportelet, në penale, civile dhe në gjykim në afat të arsyeshëm punojnë 6 (gjashtë) nëpunës ndihmës profesional gjyqësor.

Gjykata Supreme, vitin 2021 e përfundoi me 71 nëpunës gjyqësor, të punësuar nga kategoria e nëpunësve udhëheqës, profesional dhe ndihmës nëpunës administrativ gjyqësor, 5 – pjesëtarë të policisë gjyqësore dhe 7 të punësuar në shërbimin teknik. Kështu numri i zvogëluar i nëpunësve gjyqësorë nuk përputhet me vëllimin e punës në gjykatë dhe me numrin e gjyqtarëve.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE

1. Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në vitin raportues 2021 kompetencat e saj kushtetuese dhe ligjore i ka realizuar në rrethana të jashtëzakonshme si rezultat i pandemisë së shkaktuar nga Kovid-19 dhe me numër të zvogëluar të gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore.

Në vitin 2021 Gjykata Supreme ka pasur gjithsej **3098** lëndë në punë nga të gjitha llojet, nga të cilat **31** lëndë të evidentuara përsëri në punë, **2** lëndë udhëhiqen si gabimisht të evidentuara.

Viti ka filluar me **943** lëndë të pakryera nga viti 2020, ndërsa gjatë vitit janë pranuar **2126** lëndë të reja. Prej tyre janë kryer **2142** lëndë, kanë mbetur të pakryera **956** lëndë.

Gjatë vitit Gjykata Supreme tërësisht e ka tejkaluar fluksin e lëndëve të reja, ndërsa nuk e ka tejkaluar mbetjen e vetëm **13** lëndëve në nivel të Gjykatës.

2. Sektori i veprave penale gjatë vitit raportues **2021**, gjithsej në punë nga të gjitha bazat ka pasur **763** lëndë, nga të cilat të kryera **639** lëndë përkatësisht **83,74%**, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur të pakryera **124** lëndë nga të gjitha bazat.

Nga gjithsej numri i lëndëve të pakryera, ndikim të konsiderueshëm ka gjendja që **47 lëndë** përkatësisht **37,90%** të cilat janë dhënë për mendim në Prokurorinë Publike të Republikës së

Maqedonisë së Veriut, nuk janë kthyer deri më 31.12.2021, në mënyrë që të njëjtat edhe nuk janë vendosur gjatë vitit 2021, rrethanë kjo që ka ndikuar edhe në zvarritjen e procedurës dhe vendimmarrjes së lëndëve të theksuara.

Gjatë vitit 2021 për Regjistrin **RKP** – lëndë të ndryshme penale janë pranuar 40 parashtresa dhe për të njëjtat është vepruar.

Gjatë vitit 2021 për shkak pandemisë së KOVID 19, që shkaktoi realizimin e vështirë të kompetencës, për shkak që gjyqtarët, këshilltarët gjyqësor dhe administrata gjyqësore me përpjekje shtesë kanë arritur sukses që me kohë dhe në mënyrë efikase i realizon të gjitha obligimet e punës në këtë Sektor dhe në Gjykatën.

Këto rrethana objektive paraqesin shkaqe relevante dhe të arsyeshme që ndikojnë në realizimin e principit të përditësimit dhe efikasitetit në veprimin e Sektorit.

3. Sektori i veprave civile, në periudhën raportuese, gjithsej në punë ka pasur 1.765 lëndë, nga të cilat 1148 lëndë të kryera, ndërsa të pakryera kanë mbetur edhe 617 lëndë. fluksi është tejkaluar në tërësi, ndërsa mbetja është zvogëluar për 13 lëndë. Për shkak të rritjes së punës efikase të gjyqtarëve ekziston nevoja që të plotësohet numri i vendeve të zbrazura të gjyqtarëve. Ky Sektor, vitin raportues e ka përfunduar në mënyrë të përditësuar.

4. Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm, në periudhën raportuese, ka vepruar për 542 lëndë, për të gjitha bazat, në të dyja shkallët e vendosjes. Janë kryer 331 lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur 211 lëndë. Nga këtu, mund të përfundojmë se fluksi i lëndëve nuk është tejkaluar, ndërsa mbetja është rritur për 34 lëndë. Krahasuar me vitin 2020, ku numri i lëndëve të reja të pranuar ka shënuar 361 lëndë, numri i lëndëve të kryera në vitin 2020 ka qenë 392 lëndë përkatësisht për 61 lëndë më shumë në krahasim me periudhën raportuese.

Numri i zvogëluar i lëndëve të kryera në krahasim me vitin e kaluar, i dedikohet disa faktorëve objektiv, ndër të cilat më e rëndësishme është gjendja me pandeminë Covid – 19, e cila dukshëm ka ndikuar në punën e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo posaçërisht ka të bëjë me masat që Qeveria e RMV i miratoi për mbrojtjen nga zgjerimi dhe bartja e virusit, e që kishin të bëjnë me lirimimin e grave shtatzëna, lirimimin nga detyrat e punës të personave për shkak të ri infektimit dhe lirimimin e personave në vet izolim të detyrueshëm, të cilët dukshëm e zvogëluan kapacitetin e punës së Sektorit.

Në vitin raportues 2021, krahasuar me vitin 2020 është zvogëluar shuma e gjithsej kompensimit të caktuar në para, të shqiptuar për shkak të shkeljes së konstatuar për të drejtën e gjykimit në afat të arsyeshëm. Gjithsej kompensimi i caktuar i shqiptuar për shkak të shkeljes së konstatuar për të drejtën e gjykimit në afat të arsyeshëm në vitin 2020 në shkallën e parë ka qenë 8.058.900 denarë, përderisa në shkallën e dytë ka qenë 391.800 denarë, përkatësisht shuma totale në të dyja shkallët prej 8.450.700 denarëve, krahasuar me kompensimin gjithsej të shqiptuar për vitin 2021 në shumë prej 3.406.775 denarë. Lartësia e kompensimit të shqiptuar është më i ulët dhe është larg nga praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke i marrë parasysh kompensimet e caktuara nga GJEDNJ gjatë marrëveshjes miqësore të Republikës së Maqedonisë së Veriut me aplikuesit. Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm, do të bëjë analizën dhe vlerësimin për ndryshimin e lartësisë së kompensimeve të shqiptuara.

Duke marrë parasysh të sipër theksuarën mund të përfundojmë se gjyqtarët, këshilltarët gjyqësor dhe të punësuarit në sportelin gjyqësor të Sektorit, gjatë vitit raportues 2021, kontribuuan që Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut të jetë më i përditësuar dhe më efikas, duke marrë parasysh numrin e lëndëve në shkallën e parë dhe të dytë, për të gjitha bazat. Mënyra e këtillë e punës, jep të drejtën që Sektori edhe më tej të vazhdojë të punojë me vendimmarrjen e lëndëve në afat të arsyeshëm me vendime kualitative, me angazhimin për zgjidhjen e çështjeve rreth dorëzimit të shkresave të lëndëve, për të cilat është parashtruar kërkesë për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm.

5. Sektori i praktikës gjyqësore në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në një pjesë të konsiderueshme i realizoi detyrat e nënvizuara të programit.

Për realizimin e rolit dhe funksionit të Sektorit të praktikës gjyqësore, në përputhje me vendin dhe rolin e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut si gjykatë më e lartë, që me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka kompetencë që ta harmonizojë zbatimin e ligjeve nga gjykatat, Sektori i praktikës gjyqësore e konstatoi nevojën e futjes së një pajisjeje të re elektronike për përparimin edhe kërkimin efikas të praktikës gjyqësore, që do të jetë në dispozicion të brendshëm për të gjithë gjyqtarët dhe këshilltarët gjyqësor në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

6. Konstatim i përgjithshëm që rezulton nga të dhënat e punës dhe angazhimit të gjyqtarëve, dhe për shkak të rritjes së efikasitetit është e nevojshme të plotësohen vendet e zbrazura të gjyqtarëve, ngase të gjithë gjyqtarët krahas veprimit të lëndëve në sektor, kanë marrë pjesë në vendimmarrjen e kërkesave për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm në shkallën e parë dhe në këshillin e dytë që vendos për ankesat kundër aktvendimeve të këshillit prej tre gjyqtarëve për kërkesat për gjykim në afat të arsyeshëm, në punën e Këshillit të specializuar që vendos për ankesat e kandidatit që nuk është zgjedhur për gjyqtar, përkatësisht Kryetar gjykate, në Këshillin e specializuar për vendosjen e ankesave kundër Vendimeve të Gjykatës Administrative nga neni 62 të Ligjit për konteste administrative, me propozim për mbrojtjen për veprim të paligjshëm, në punën e Sektorit të praktikës gjyqësore së bashku me bashkëpunëtorët profesional gjyqësor.

7. Nëpunësit profesional gjyqësor, gjatë vitit raportues 2021 treguan një shkallë të lartë operative me gjyqtarët në përgatitjen e projektvendimeve, si dhe shkallë të lartë të profesionalizmit, me ndërgjegje dhe përditësim në kryerjen e obligimeve të tyre punuese, por edhe krahas asaj për rritjen e efikasitetit në punën e Gjykatës, nevojitet plotësimi i vendeve të paplotësuara dhe të zbrazura të vendeve të punës nga radha e këshilltarëve udhëheqës dhe profesional gjyqësor në përputhje me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Gjykatë dhe Ligjin për shërbim gjyqësor.

8. Duke pasur parasysh rolin dhe rëndësinë e nëpunësve gjyqësorë në Gjykatën Supreme, si gjykatë më e lartë në Republikën, në procesin e sigurimit të veprimit efikas të gjykatës, që të bëhen përpjekje për ndryshimin e Ligjit për shërbim gjyqësor dhe në këtë mënyrë do të siguroheshin mundësi për përparimin, mbindërtimin dhe rritjen e numrit të nëpunësve gjyqësor, sidomos në numrin e realizuesve në sportelet gjyqësore dhe numrin e realizuesve në Qendrën e informatikës.

9. Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me kompetencën e saj, qëndrimet parimore të miratuara dhe mendimet juridike parimore, mendimet juridike dhe konkluzionet nga puna e Seancës së përgjithshme dhe mendimet juridike, konkluzionet dhe sentencat e miratuara në seancat e sektorëve, të vazhdojë vazhdimisht t'i publikojë në faqen zyrtare të Gjykatës, por edhe të vazhdojë praktikën me publikimin e Buletinit dhe Përmbledhjes së vendimeve gjyqësore.

**GJYKATA SUPREME E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
SEANCA E PËRGJITHSHME**